



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës së Prizrenit
Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001-060-86450

Më: 20 korrik 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, thërras mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **28 korrik 2026 (e martë)**, në sallën për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, duke filluar në **orën 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të KPF-së, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhje, duke i'u përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtur të KPF-së, më 29 maj 2026 (e rregullt) dhe 24 qershor 2026 (e jashtëzakonshme);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërtimin e Bibliotekës Komunale të Prizrenit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit për fshatin Zym i Hasit;
6. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar-qershor 2026;
7. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026;
8. Raport i punës së Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) për periudhën janar-qershor 2026;
9. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2025 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2025;



Kryesuesi i KPF-së
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN
Komitet za Politiku i Finansije
Br. 001-060-86450
Dana: 20 jula 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 11 Administrativnog Uputstva (MLS) Br. 05/2020 o proceduri osnivanja, sastavu i nadležnostima Privremenih Komiteta i ostalih komiteta u Opštini, sazivam sastanak Komiteta za Politiku i Finansije koja će se održati **28 jula 2026 (utorak)** u sali za sastanke KPF-je u „Beloj kući“, sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da učestvujete u radu ovog sastanka kao član Komiteta za Politiku i Finansije, pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ovog sastanka predlažem sljedeći:

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa redovnog sastanka KPF-je, od dana 29 maja 2026 (redovna) i 24 jun 2026 (vanredna);
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Razmatranje i usvajanje prijedloga odluke o imenovanju Opštinske biblioteke Prizren;
4. Razmatranje i usvajanje prijedloga odluke o imenovanju članova Saveta za kulturnu baštinu Historijskog centra Prizrena;
5. Razmatranje i usvajanje prijedloga odluke o osnivanju i imenovanju članova Saveta za selo Zym i Hasit;
6. Izvještaj o radu gradonačelnika za period januar-juni 2026 godine;
7. Finansijski izvještaj za period januar-juni 2026 godine;
8. Izvještaj o radu Opštinskog direktorijata za obrazovanje (ODO) za period januar-juni 2026 godine;
9. Diskusija o izvještaju Nacionalne revizorske kancelarije (NRK) o godišnjim finansijskim izvještajima Opštine Prizren za 2025 godinu i akcionom planu za implementaciju preporuka za 2025 godinu;



Predsedavajući KPF-je
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Prizren Belediye Meclisi
Siyasi ve Maliye Komitesi
No. 001-060-86450
Tarih : 20 Temmuz 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Belediyedeki Daimi Komitelerin ve diğer komitelerin kuruluşu, yapısı ve yetkilerine ilişkin prosedür hakkında (MPL) 05/2020 sayılı İdari Talimatın 11. maddesine dayanarak **“Beyaz Ev” SMK toplantı salonunda saat 10.00 başlamak üzere 28 Temmuz 2026 tarihinde (Salı günü)** düzenlenecek olan Siyasi ve Maliye Komitesi toplantısı için çağırıda bulunuyorum.

SMK üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz.

İşbu toplantı için aşağıda yer alanları öneriyorum:

GÜNDEM

1. 29 Mayıs 2026 (düzenli) ve 24 Haziran 2026 (olağanüstü) toplantıların tutanaklarının görüşülmesi ve onaylanması;
2. Gündemin görüşülmesi ve onaylanması;
3. Prizren Belediye Kütüphanesinin adlandırılması ile ilgili öneri – kararın görüşülmesi ve onaylanması;
4. Prizren Tarihi Merkezin Kültürel Miras Kurul üyelerinin atanmasına ilişkin öneri-kararın görüşülmesi ve onaylanması;
5. Zym i Hasit köy Kurul üyelerinin oluşturulması ve adlandırılması için öneri-kararın görüşülmesi ve onaylanması;
6. 2026 Ocak –Haziran dönemine ilişkin Belediye Başkan'ın çalışma raporu;
7. 2026 Ocak –Haziran dönemine ilişkin mali rapor;
8. 2026 Ocak –Haziran dönemine ilişkin Belediye Eğitim Müdürlüğün (BEM) çalışma raporu;
9. Prizren Belediyesi'nin 2025 yılına ait yıllık mali tablolarına ilişkin Ulusal Denetleme Ofisi (UDO) raporu ve 2025 yılı için önerilerin uygulanmasına yönelik eylem planı hakkında tartışma;



SMK Başkanı
Simir Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 320/26 Dt. 15.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 58 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 18 të Ligjit Nr.04/L-097 për Bibliotekat, nenit 7 paragrafi 6 dhe nenit 8 paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-245 për Artin dhe Kulturën dhe nenit 50 shkronja I, të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15 tetor 2008, i propozoj Kuvendit të Komunës së Prizrenit miratimin e këtij:

VENDIM PËR EMËRTIMIN E BIBLIOTEKËS KOMUNALE TË PRIZRENIT

Neni 1

Me këtë vendim biblioteka komunale (e qytetit) me seli në Prizren emërtohet me emrin biblioteka “Zahadin Shemsidini”.

Neni 2

Biblioteka është institucion në shërbimin publik, në kuadër të Komunës së Prizrenit dhe veprimtaria e saj dhe organizimi i brendshëm do të bëhet konformë akteve ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe organet tjera relevante që të i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryetari i Komunës

Shaqir Totaj





**Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kuvendi i Komunës së Prizrenit

Nr. 001-011-

Më: __ korrik 2026

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1 dhe 2 pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 14 të Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 12/2014 Për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësit dhe Funksonimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit si dhe nenit 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më __ korrik 2026, miratoi këtë:

**PROPOZIM-VENDIM
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË
QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT**

Neni 1

Anëtarë të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit emërohen:

Nga Shoqëria Civile:

1. Veron Tara,
2. Elmedina Shkurti Haxhifazliu,
3. Gjeni Krasniqi,

Nga Bashkësitë Fetare:

1. Dr. Orhan Bislímaj, nga Bashkësia Islame;
2. Lorenc Shala, nga Kisha Katolike;
3. Svetlana Hadžić, nga Kisha Ortodokse Serbe;

Nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim:

1. Islam Elshani.

Neni 2

Këshilli zgjedh Kryesuesin e Këshillit nga radhët e anëtarëve të tij. Kryesuesi zgjidhet me votim të fshehtë nga shumica e anëtarëve të Këshillit.

Neni 3

Anëtarët e emëruar sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohen për mandat tre (3) vjeçar. Në rast të dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit, zëvendësimi bëhet në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 4

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit përcaktohen me Ligjin Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 12/2014 dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi



**Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Skupština opštine Prizren

Br. 001-011-

Dana: __ jula 2026

Na osnovu člana 12 stav 1 i 2 tačka d) Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, člana 14 Zakona br. 04/L-066 o Istorijском centru Prizrena, odredbi Administrativnog Uputstva Ministarstva zaštite životne sredine i prostornog planiranja br. 12/2014 o osnivanju, izboru, odgovornostima i funkcionisanju Saveta za kulturno nasleđe Prizrena i Kancelarije za istorijski centar Prizrena, kao i člana 27 stav 1 Statuta opštine Prizren, Skupština opštine Prizren, na sjednici održanoj __ jula 2026 godine, odobrila je ovu:

**PREDLOG-ODLUKU
ZA IMENOVANJE ČLANOVA SAVETA ZA KULTURNO
NASLEĐE ISTORIJSKOG CENTRA PRIZRENA**

Član 1

Imenuju se članovi Saveta za kulturno nasleđe Istorijскоg centra Prizrena:

Iz civilnog društva:

1. Veron Tara,
2. Elmedina Shkurti Haxhifazliu,
3. Gjeni Krasniqi

Iz vjerskih zajednica:

1. Dr. Orhan Bislimaj, iz Islamske zajednice;
2. Lorenc Shala, iz Katoličke crkve;
3. Svetlana Hadžić, iz Srpske pravoslavne crkve;

Iz Opštinske Kancelarije za Zajednice i Povratak:

1. Islam Elshani.

Član 2

Savet bira predsjedavajućeg Saveta iz redova svojih članova. Predsjedavajući se bira tajnim glasanjem većinom glasova članova Saveta.

Član 3

Članovi imenovani u skladu s članom 1 ove odluke imenuju se na mandat od tri (3) godine. U slučaju ostavke ili razrješenja člana, zamjena će se izvršiti u skladu s važećim zakonom.

Član 4

Dužnosti, ovlaštenja i odgovornosti Saveta utvrđene su Zakonom br. 04/L-066 o historijskom centru Prizrena, Administrativnim Uputstvom MAPP br. 12/2014 i drugim važećim zakonskim i podzakonskim aktima.

Član 5

Ova odluka stupa na snagu nakon što bude dostavljena nadzornom organu, u smislu člana 8 u vezi sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 za Administrativno Razmatranje Opštinskih Akata i sedam (7) dana nakon objavljivanja na službenoj web stranici opštine.

Predsedavajući Skupštine
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Prizren Belediye Meclisi
No: 001-011-
Tarih: ____ Temmuz 2026

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kosova Cumhuriyeti Yerel Özyönetim Hakkında 03/L-040 sayılı Kanun'un 12. maddesinin 1. ve 2. fıkrası (d) bendi, Prizren Tarihi Merkezi Hakkında 04/L-066 sayılı Kanun'un 14. maddesi, Prizren Kültürel Miras Konseyi ile Prizren Tarihi Merkez Ofisinin Kurulması, Seçilmesi, Görevleri ve İşleyişi Hakkında ÇŞPB İdari Talimatı No. 12/2014 hükümleri ile Prizren Belediyesi Statüsü'nün 27. maddesinin 1. fıkrası uyarınca, Prizren Belediye Meclisi, ____ Temmuz 2026 tarihinde yapılan toplantısında aşağıdaki kararı kabul etmiştir:

PRİZREN TARİHİ MERKEZİ KÜLTÜREL MİRAS KONSEYİ ÜYELERİNİN ATANMASI HAKKINDA ÖNERİ KARAR

Madde 1

Prizren Tarihi Merkezi Kültürel Miras Konseyi üyeleri aşağıdaki şekilde atanmıştır:

Sivil Toplum Temsilcileri:

1. Veron Tara,
2. Elmedina Shkurti Haxhifazliu,
3. Gjeni Krasniqi.

Dini Topluluk Temsilcileri:

1. Kosova İslam Birliği adına Dr. Orhan Bislimaj,
2. Katolik Kilisesi adına Lorenc Shala,
3. Sırp Ortodoks Kilisesi adına Svetlana Hadžić.

Belediye Topluluklar ve Geri Dönüş Ofisi Temsilcisi:

1. Islam Elshani.

Madde 2

Konsey, Başkanını kendi üyeleri arasından seçer. Başkan, Konsey üyelerinin çoğunluğunun gizli oyu ile seçilir.

Madde 3

Bu kararın 1. maddesi uyarınca atanan üyeler üç (3) yıllık bir görev süresi için atanırlar. Üyenin istifa etmesi veya görevden alınması halinde, yerine yeni üyenin atanması yürürlükteki mevzuata uygun olarak yapılır.

Madde 4

Konseyin görev, yetki ve sorumlulukları, Prizren Tarihi Merkezi Hakkında 04/L-066 sayılı Kanun, ÇŞPB İdari Talimatı No. 12/2014 ile yürürlükte bulunan diğer yasal ve ikincil mevzuat hükümleriyle belirlenir.


Madde 5

Bu karar, Belediye İşlemlerinin İdari İncelenmesi Hakkında 08/L-284 sayılı Kanun'un 8. maddesi ile bağlantılı olarak 9. maddesi uyarınca denetim makamına gönderildikten sonra ve belediyenin resmî internet sayfasında yayımlanmasını takip eden yedi (7) günün sonunda yürürlüğe girer.

Belediye Meclisi Başkanı
Simir Krasniqi

RAPORT PËRMbledhës

Mbi ecurinë e përzgjedhjes së Anëtarëve të
Këshillit për Trashëgimi Kulturor të
Qendrës Historike të Prizrenit



Komisioni *Ad-Hoc* për Përzgjedhjen e
Anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturor
të Qendrës Historike të Prizrenit

PËRMBATJA

Hyrja	3
Ecuria e Procesit	4
Komisioni AdHoc, për për zgjedhjen e Anëtarëve të KTKQHP	4
Vlerësimi Teknik	5
Vlerësimi me Shkrim	6
Vlerësimi me Gojë	7
Rezultatet e Procesit të Përzgjedhjes – tre (3) me më së shumti poena	8
PËRFUNDIM	9
Lista e plotë - për emërimin e Anëtarëve të KTKQHP	9

RAPORT PËRMBLEDHËS

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit

I. HYRJE

Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit, qëllimi i të cilit është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë, të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar, udhëzon për themelimin e një mekanizmi këshillëdhënës të quajtur “Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit”.

Roli i Këshillit është të vëzhgojë dhe këshillojë rreth aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore.

Ky këshill duhet të themelohet nga Komuna e Prizrenit dhe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

- tre (3) anëtarë nga shoqëria civile
- një (1) anëtar përzgjidhet nga Bashkësia Islame;
- një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe dhe
- një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Katolike;
- anëtari i shtatë do të jetë përfaqësues i Zyrës Komunale përgjegjëse për Komunitete dhe Kthim.

Anëtarët e Këshillit emërohen prej Kuvendit të Komunës për periudhë (tri) 3 vjeçare, përmes procedurës e cila përfshin ftesë publike duke i përcaktuar kushtet për konkurrim dhe anëtarësim. Asambleja Komunale emëron anëtarët e Këshillit të përzgjedhur nga Kisha Katolike, Bashkësia Islame dhe nga Kisha Ortodokse Serbe për këtë mandat.

¹ KTKQHP -Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit

II. ECURIA E PROCESIT

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat derivojnë nga Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Udhëzimi Administrativ MMPH – Nr. 12/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funksionimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit me 26 shkurt 2026, merr vendim për themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe iniciimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të tij, ku në kuadër të atij vendimi është vendosur që të bëhet thirrja publike dhe janë përcaktuar kriteret për konkurrim dhe anëtarësim në KTKQHP.

Komisioni AdHoc, për përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit.

Më datën 30 prill 2026 Kuvendi i Komunës së Prizrenit merr vendim për formimin dhe caktimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, i cili përbëhej prej 5 anëtarëve: dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës dhe tre (3) anëtarë nga shoqëria civile. Nga Kuvendi i Komunës ishin Dea Gavazaj dhe Onur Kovaçi. Ndërsa nga shoqëria civile ishin Valon Xhabali, Fatmir Menekshe dhe Katarina Kajtazi.

Më datën 11 qershor 2026 nga Kryesuesi i Kuvendit është thirrur mbledhja konstituive e komisionit ad hoc, ku në rend dite ishte konstituimi i komisionit dhe zgjedhja e kryesuesit të komisionit ad-hoc. Në këtë takim ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit ad-hoc. Me vota unanime kryesues i komisionit u zgjodh z.Valon Xhabali. Në të njejtën takim Kryesuesi i Kuvendit njoftoi se do të bëhet publikimi i ftesës publike dhe për ftesën publike do të njoftohen të gjitha Bashkësitë Fetare, Kryetari i Komunës dhe Zyra Komunale përgjegjëse për Komunitete dhe Kthim. Ftesa ishte e hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes, përkatësisht deri më 26 qershor 2026 dhe aplikimet e kandidatëve do të pranoheshin në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit.

Komisioni ad-hoc kishte për detyrë të bënte zgjedhjen e kandidatëve që kanë konkurruar për anëtar të Këshillit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së skadimit të afatit për aplikim. Për zbatimin e vendimit do të kujdeseshin anëtarët e Komisionit *ad-hoc* dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Detyrat e komisionit ad-hoc, sipas vendimit të Kuvendit ishin: të verifikojë a është bërë aplikimi nga kandidatët brenda afatit kohor; të verifikojë a i plotësojnë kandidatet kriteret e selektimit; të bëjë intervistimin e kandidatëve si dhe të ushtrojë detyrat e tjera të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ MMPH - Nr. 12/2014; të dërgoj listën e zgjedhur të kandidatëve për votim në Kuvendin Komunal.

○ Vlerësimi teknik:

Më datën 26 dhe 29 qershor 2026, Komisioni ad-hoc trajtoi dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantët, në raport me kriteret e kërkuara sipas ftesës publike.

Procesi: Në këtë fazë vlerësimi, gjithësejt njëmbëdhjetë (11) aplikacione ishin dorëzuar brenda afatit kohor (shtatë (7) shoqëria civile, tre (3) bashkësitë fetare dhe një (1) zyra komunale për komunitete dhe kthim). Pas procedurës së vlerësimit teknik, është konstatuar se nga shoqëria civile: gjashtë (6) aplikacione i kanë përmbushur kriteret e ftesës publike duke u kualifikuar në fazën e dytë vlerësuese, ndërsa një (1) aplikant kishte dosje të pa kompletuar. Në këtë fazë nga Komisioni ad-hoc është vendosur edhe 02 korrik 2026 data e mbajtjes së testit me shkrim dhe është kërkuar nga zyra e kryesuesit që të bëhet njoftimi tek të gjithë kandidatët që i kanë përmbushur kriteret si dhe të dërgohet njoftimi për kandidatin që nuk ka kaluar në fazën tjetër.

Nga tre (3) bashkësitë fetare dhe zyra komunale për komunitete dhe kthim në këtë fazë kanë përcjellur vetëm letër delegimin e të përzgjedhurve. Nga Komisioni ad-hoc sipas legjislacionit në fuqi, iu është kërkuar edhe dokumentacioni përcjellës i kërkuar në thirrje publike për të konstatuar se a i plotësojnë kriteret e selektimit të përzgjedhurit e tyre *(të përzgjedhurit e tyre nuk i nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës)*. Të gjitha dokumentacionet e sipas thirrjes publike janë dërguar dhe komisioni ka konstatuar se të përzgjedhurit e tyre i plotësojnë kriteret.

○ Vlerësimin me shkrim:

Niveli i vlerësimit me shkrim, trajtoi njohuritë paraprake të aplikantëve në raport me ambientin ligjor, dhe zhvillimet rreth Qendrës Historike të Prizrenit.

Për këtë qëllim është hartuar një pyetësor me dhjetë (10) pyetje, dy (2) të formës së hapur, dhe tetë (8) me opzione. Secili nga anëtarët e Komisionit ad-hoc do të propozonte nga dy (2) pyetje, propozimet e të cilëve do të silleshin një orë para mbajtjes së vlerësimit me shkrim, dhe do të vendoseshin në pyetësor. Vendosja e pyetjeve në pyetësor u aprovua unanimisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit AdHoc. Secila nga pyetjet e pyetësorit do të përcillej me notë pikësimi deri në dhjetë (10) poena. Testi me shkrim u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe filloi në ora 15:00. Koha në dispozicion e aplikantëve për plotësimin e pyetësorit ishte gjashtëdhjetë (60) minuta. Të gjithë anëtarët e ftuar gjashtë (6) iu nënshtruan testin me shkrim. Nga komisioni ad-hoc u mor vendim që vlerësimi i testit me shkrim të bëhet menjëherë pas përfundimit të testit nga kandidatët. Pas përfundimit të vlerësimit, komisioni ka dorëzuar dokumentacionin tek zyra e kryesuesit dhe ka kërkuar që të njoftohen të gjithë kandidatët me rezultatin e arritur në këtë fazë si dhe njëkohësisht të njoftohen për mbajtjen e intervistës me gojë për datën 07 korrik 2026.

○ Vlerësimin me gojë:

Niveli i vlerësimit me gojë kishte për qëllim që të identifikonte njohuritë e përgjithshme të aplikantëve në raport me trashëgiminë kulturore, dhe kreativitetin për tu përballur me sfidat e menaxhimit të proceseve për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë, të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Secili nga anëtarët e Këshillit ad-hoc do të propozonte nga një (1) pyetje, propozimet e të cilëve do të silleshin një orë para mbajtjes së vlerësimit me gojë. Vendosja dhe koordinimi rreth pyetjeve dhe poentimi u aprovua unanimisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit ad-hoc. Intervistimi me gojë u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe filloi nga ora 11:00 deri më 14:00.

Koha në dispozicion e aplikantëve për tu përgjigjur ishte tridhjetë (30) minuta.

Procesi: Në këtë fazë finale të vlerësimit nga gjashtë (6) aplikant sa ishin gjithsej, tre (3) nga ta u kualifikuan për tu përzgjedhur Anëtarë të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, për një mandat tre (3) vjeçar. Përzgjedhja u realizua duke i mbledhur pikët e aplikantëve nga të dyja fazat e vlerësimit; me shkrim dhe me gojë, dhe të njetat më pas të pjestuara për dy (2). Nga Komisioni ad-hoc u vendos që kandidatët të njoftohet veçmas për pikët e tyre të totalit të të 2 vlerësimeve si dhe të njoftohen për listen finale të të përzgjedhurve nga të dyja fazat. Pas përfundimit të vlerësimeve dhe punimeve, dokumentacioni u dorëzua në zyrën e kryesuesit.

III. REZULTATET E PROCESIT TË PËRZGJEDHJES

Anëtarët e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit, bazuar në rezultatet e dala nga procesi i ftesës publike për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturor të Prizrenit, rekomandon si në vijim:

Titulli i pozitës: Anëtarë i Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit.

Numri i përzgjedhjes në bazë të arritjes më të larta të pikëve: **tre (3)**

Kandidatët nga shoqëria civile janë testuar me shkrim më datë 02 korrik 2026, dhe në intervistë me gojë, më datë 07 korrik 2026. Në paraqitjen tabelare si më poshtë, aplikantët janë renditur sipas rezultateve të arritura në procesin e vlerësimit, duke u bazuar sipas kritereve të ftesës publike.

Emri dhe Mbiemri	Totali i pikëve në Test	Totali i pikëve në Intervistë	Pikët totale të fituara
Veron Tara	97	100	98.5
Elmedina Shkurti Haxhifazliu	100	96	98
Gjeni Krasniqi	100	89	94.5
Edin Gështenja	91	68	79.5
Afrim Tejeci	80	39	59.5
Burim Kastrati	49	31	40

IV. PËRFUNDIM

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, bazuar në rezultatet e përzgjedhjes nga Thirrja Publike për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, më datën 10 korrik 2026, dërgon listën e plotë në Kuvendin e Komunës për emërim, si vijon:

Nga Shoqëria Civile:

1. **Veron Tara,**
2. **Elmedina Shkurti Haxhifazliu,**
3. **Gjeni Krasniqi,**

Nga Bashkësitë Fetare:

1. **Dr. Orhan Bislimaj, nga Bashkësia Islame;**
2. **Lorenc Shala, nga Kisha Katolike;**
3. **Svetlana Hadžić, nga Kisha Ortodokse Serbe**

Nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim:

1. **Islam Elshani**

Anëtarët e Komisionit Ad-Hoc

1. Valon Xhabali / kryesues
2. Dea Gavazaj / anëtare
3. Onur Kovaçi / anëtar
4. Fatmir Menekshe / anëtar
5. Katarina Kajtazi / anëtare

² AdHoc - është një frazë latine që do të thotë 'për këtë'. Në anglishte, nënkupton një zgjidhje për një qëllim, problem ose detyrë të veçantë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi i Komunës së Prizrenit

Nr. 001-011-

Më: __ korrik 2026

Në bazë të nenit 12 paragrafit 1 dhe 2 shkronja d), nenit 51 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-196 për fshatin Zym i Hasit, nenit 27 paragrafit 1 dhe nenit 58 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen __ korrik 2026, miratoi këtë:

PROPOZIM-VENDIM
PËR THEMELIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT PËR
FSHATIN ZYM I HASIT

Neni 1

Me këtë vendim themelohet Këshilli i fshatit Zym i Hasit. Këshilli përbëhet prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

Tre (3) anëtarë të zgjedhur drejtpërdrejtë nga banorët e fshatit Zym i Hasit:

1. Muharrem Çollaku;
2. Arbnor Çollaku;
3. Bal Kajzogaj.

Dy (2) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës:

1.
2.

Neni 2

Këshilli e zgjedh Kryetarin e Këshillit nga anëtarët e tij, i cili duhet të jetë banorë i këtij fshati, zgjedhja e të cilit bëhet me vota të fshehta të anëtarëve të Këshillit.

Neni 3

Anëtarët e Këshillit kanë mandatin e njëjtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 4

Këshilli dhe Kryetari i Këshillit ushtrojnë veprimtaritë e tyre në bazë të Ligjit nr. 04/L-196 për fshatin Zym i Hasit dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Skupština opštine Prizren

Br. 001-011-

Dana: __ jula 2026

Na osnovu člana 12 stav 1 i 2 slovo d), člana 51 stav 2 Zakona br. 03/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, člana 4 Zakona br. 04/L-196 o selu Zym i Hasit, člana 27 stav 1 i člana 58 stav 2 Statuta opštine Prizren br. 01/011-5643 od 15.10.2008. godine, Skupština opštine Prizren, na svojoj sjednici održanoj __ jula 2026 godine, odobrila je ovu:

PREDLOG-ODLUKU
ZA OSNIVANJE I IMENOVANJE ČLANOVA
SAVETA ZA SELO ZYM I HASIT

Član 1

Ovom odlukom se formira Savet sela Zym i Hasit. Savet se sastoji od pet (5) članova, i to:

Tri (3) člana koje direktno biraju meštani sela Zym i Hasit:

1. Muharrem Çollaku;
2. Arbnor Çollaku;
3. Bal Kajzogaj.

Dva (2) člana koje bira Skupština opštine:

1.
2.

Član 2

Savet bira predsjedavajućeg Saveta iz svojih redova, koji mora biti meštаниn ovog sela, a čiji se izbor vrši tajnim glasanjem članova Saveta.

Član 3

Članovi Saveta imaju isti mandat kao i odbornici Skupštine opštine s pravom ponovnog izbora.

Član 4

Savet i predsjedavajući Saveta obavljaju svoje aktivnosti na osnovu Zakona br. 04/L-196 o selu Zym i Hasit i drugih zakonskih i podzakonskih akata koji regulišu ovu oblast.

Član 5

Ova odluka stupa na snagu nakon što bude dostavljena nadzornom organu, u smislu člana 8 u vezi sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 za Administrativno Razmatranje Opštinskih Akata i sedam (7) dana nakon objavljivanja na službenoj web stranici opštine.

**Predsjedavajući Skupštine
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Prizren Belediye Meclisi

No: 001-011-

Tarih: ____ Temmuz 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kosova Cumhuriyeti Yerel Özyönetim Hakkında 03/L-040 sayılı Kanun'un 12. maddesinin 1. ve 2. fıkrası (d) bendi ile 51. maddesinin 2. fıkrası, Zym i Hasit Köyü Hakkında 04/L-196 sayılı Kanun'un 4. maddesi, Prizren Belediyesi Statüsü'nün 15.10.2008 tarih ve 01/011-5643 sayılı 27. maddesinin 1. fıkrası ile 58. maddesinin 2. fıkrası uyarınca, Prizren Belediye Meclisi, ____ Temmuz 2026 tarihinde yapılan toplantısında aşağıdaki kararı kabul etmiştir:

ZYM I HASIT KÖYÜ KONSEYİNİN KURULMASI VE ÜYELERİNİN ATANMASI HAKKINDA ÖNERİ KARAR

Madde 1

Bu Kararla, Zym i Hasit Köyü Konseyi kurulmuştur. Konsey aşağıdaki şekilde beş (5) üyeden oluşmaktadır:

Zym i Hasit köyü sakinleri tarafından doğrudan seçilen üç (3) üye:

1. Muharrem Çollaku;
2. Arbnor Çollaku;
3. Bal Kajzogaj.

Belediye Meclisi tarafından seçilen iki (2) üye:

1.
2.

Madde 2

Konsey, Başkanını kendi üyeleri arasından seçer. Başkanın bu köyün sakini olması zorunludur. Başkan, Konsey üyelerinin gizli oylamasıyla seçilir.

Madde 3

Konsey üyelerinin görev süresi, Belediye Meclisi üyelerinin görev süresi ile aynıdır ve yeniden seçilme hakları vardır.

Madde 4

Konsey ve Konsey Başkanı, faaliyetlerini Zym i Hasit Köyü Hakkında 04/L-196 sayılı Kanun ile bu alanı düzenleyen diğer yürürlükteki yasal ve ikincil mevzuat hükümlerine uygun olarak yürütür.

Madde 5

Bu karar, Belediye İşlemlerinin İdari İncelenmesi Hakkında 08/L-284 sayılı Kanun'un 8. maddesi ile bağlantılı olarak 9. maddesi uyarınca denetim makamına gönderildikten sonra ve belediyenin resmî internet sayfasında yayımlanmasını takip eden yedi (7) günün sonunda yürürlüğe girer.

Belediye Meclisi Başkanı
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

RAPORT PËRMBLEDHËS

**KOMISIONI AD HOC PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË TRE (3)
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË FSHATIT ZYM I HASIT.**

Prizren, Korrik 2026

PËRMBATJA:

Hyrje.....	3
Komisioni ad hoc për organizimin e procesit të zgjedhjes së tre (3) anëtarëve të këshillit të fshatit Zym i Hasit	3
Ftesa publike, njoftimi dhe organizimi i procesit të votimit	4
Rezultatet e procesit të votimit	4
Përfundim - Dërgimi i listës së tre (3) anëtarëve të zgjedhur për miratim në Kuvend të Komunës.....	5

1. HYRJE

Ligji Nr.04/L-196 për Fshatin Zym i Hasit, qëllimi i të cilit është mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore e fshatit Zym i Hasit dhe promovimi i tij si fshat me vlera kulturore të rëndësishme lokale, shtetërore e ndërkombëtare si dhe zhvillimi i qëndrueshëm dhe harmonizimi i tij, udhëzon për themelimin e një mekanizmi të quajtur Këshilli për fshatin Zym i Hasit.

Roli i Këshillit është të përfaqësojë interesat e Fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore si dhe në fushën e planifikimit hapësinor dhe rural.

Këshillin e themelon Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Këshilli përbëhet prej pesë (5) anëtarëve:

tre (3) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejtë nga banorët e fshatit të Zym i Hasit ;

dy (2) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Komunës;

Anëtarët e Këshillit zgjedhën me mandatin e njëjtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës me të drejtë rizgjedhjeje.

2. KOMISIONI AD HOC PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË TRE (3) ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË FSHATIT ZYM I HASIT

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.04/L-196 për Fshatin Zym i Hasit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit më datë 26 shkurt 2026, ka miratuar vendimit për formimin e komisioni *ad hoc* për organizimin e procesit të zgjedhjes së tre (3) anëtarëve të Këshillit të Fshatit Zym i Hasit.

Komisioni Ad-hoc përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Kuvendit të Komunës: Adrit Krasniqi, Shqipe Shatri, Bajram Kastrati, Sefidin Islamaj, Sevilay Hapçi.

Më datën 26 maj 2026 nga Kryesuesi i Kuvendit është thirrur mbledhja konstituive e komisionit ad hoc, ku në rend dite ishte konstituimi i komisionit dhe zgjedhja e kryesuesit të komisionit ad-hoc. Në këtë takim ishin të pranishëm Adrit Krasniqi, Bajram Kastrati, Sefidin Islamaj. Ndërsa munguan Shqipe Shatri dhe Sevilay Hapçi. Me vota unanime të anëtarëve të pranishëm kryesues i komisionit u zgjodh z.Bajram Kastrati.

Komisioni ad-hoc sipas vendimit të Kuvendit, kishte për detyrë që të: Hartojë dhe publikoj ftesën publike për organizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Fshatit Zym i Hasit; të njoftoj banorët e fshatit Zym i Hasit për mbajtjen e takimit përmes burimeve informuese; të organizojë procesin e zgjedhjes dhe siguron mbarëvajtjen e tij; dhe të dërgon listën e tre (3) anëtarëve të zgjedhur nga banorët e fshatit Zym i Hasit, në Kuvend të Komunës për miratim.

Për zbatimin e vendimit do të kujdeseshin anëtarët e komisionit *ad-hoc* dhe administrata komunale.

3. FTESA PUBLIKE, NJOFTIMI DHE ORGANIZIMI I PROCESIT TË VOTIMIT

Më datë 22 qershor 2026, Komisioni Ad-hoc ka hartuar ftesën publike dhe ka bërë njoftimin zyrtar mbi mbajtjen e zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Kriteret, data, vendi dhe ora e mbajtjes së takimit u shpallën në pikat kryesore publike të fshatit Zym dhe në mjete të informimit.

Takimi me banorët e fshatit u mbajt në Objektin e Shtëpisë së Kulturës në fshatin Zym i Hasit, më datë 29 qershor 2026, duke filluar nga ora 17:00 deri në orën 19:00. Të pranishëm nga anëtarët e Komisionit ad-hoc ishin Adrit Krasniqi, Bajram Kastrati, Sefidin Islamaj dhe Shqipe Shatri, ndërsa mungoi Sevilay Hapçi.

Pjesëmarrja ishte: 36 banorë nga fshati Zym i Hasit dhe 3 banorë nga fshatrat e tjerë të cilët më pastaj u larguan nga takimi pasi kryesuesi i komisionit ad-hoc i sqaroi rregullat ligjore dhe interpretimet nga organet e nivelit qendror, që ky takim vlen vetëm për banorët e fshatit Zym i Hasit.

Komisioni ad-hoc sqaroi banorëve të fshatit procedurën propozimit dhe votimit. Nga banorët e pranishëm u propozuan dhe garuan pesë (5) anëtarë.

Procesi u zhvillua sipas rregullave të votimit të fshehtë në kabina. Secili banor i pranishëm me të drejtë vote u regjistrua në listën e pjesëmarrësve para pranimi të fletëvotimit zyrtar. Procesi i votimit u monitorua nga anëtarët e Komisionit Ad-Hoc.

Pas mbylljes së votimit në ora 18:10, kutia e votimit u hap publikisht në prani të të gjithë banorëve të pranishëm dhe u fillua me numërimin e fletëvotimeve. Në votim kanë marrë pjesë 36 banorë të fshatit Zym, të gjitha votat ishin të vlefshme. Gjatë gjithë procesit nuk u raportua asnjë parregullsi, ankesë apo incident që do të mund të cenonte integritetin e procesit. Pas përfundimit të procesit, dokumentacioni zyrtar i punimeve u dorëzua në sektorin e Kuvendit.

4. REZULTATET E PROCESIT TË VOTIMIT

Pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve, Komisioni Ad-Hoc doli me njoftim për rezultatet e zgjedhjes së tre (3) anëtarëve të Këshillit për fshatin Zym i Hasit, sipas numrit të votave të grumbulluara:

Renditja	Emri dhe Mbiemri	Numri i Votave	Rezultati
1	Muharrem Çollaku	24	I zgjedhur
2	Arbnor Çollaku	22	I zgjedhur
3	Bal Kajzogaj	20	I zgjedhur
4	Hil Prenkpalaj	17	
5	Lajde Kolgjera	14	

6. PËRFUNDIM - DËRGIMI I LISTËS SË TRE (3) TË ZGJEDHURVE PËR MIRATIM NË KUVEND TË KOMUNËS

Duke u bazuar në rezultatet zyrtare të shprehura drejtpërdrejt nga banorët e fshatit Zym i Hasit përmes votimit të fshehtë, Komisioni Ad-Hoc e dërgon për miratim në Kuvend të Komunës së Prizrenit, listën e tre (3) anëtarëve të zgjedhur për anëtarë të Këshillit për fshatin Zym i Hasit, si vijon:

1. Muharrem Çollaku

2. Arbnor Çollaku

3. Bal Kajzogaj

Anëtarët e Komisionit Ad-Hoc:

Bajram Kastrati / Kryesues

Adrit Krasniqi / anëtar

Shqipe Shatri / anëtare

Sefidin Islamaj / anëtar

Sevilay Hapçi / anëtare



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 285/26 Dt. 30.06.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT

Janar-Qershor 2026



Qershor 2026

Përmbajtja:

Kryetari i Komunës – fjalë hyrëse.....	3
Takimet dhe aktivitetet e Kryetarit.....	4
Projekti GRCFW2 – Rritja e Eficiencës së Energjisë në Objektet Publike	7
RAPORTET E PUNËS SË ZYREVE TË KRYETARIT	8
1. Zyra e Auditimit të Brendshëm	8
2. Zyra për Integritet Evropian.....	9
3. Zyra për Informim.....	9
3.1. Publikimi i dokumenteve:.....	10
3.2. Hartimi i dokumenteve:.....	10
4. Zyra Ligjore	11
5. Zyra e Burimeve Njerëzore.....	11
5.1. Trajtimi i lëndëve dhe komunikimeve zyrtare	12
5.2. Administrimi i dosjeve dhe sistemit HRMIS	12
5.3. Menaxhimi i marrëdhënieve të punës	12
5.4. Konkursi i procedurave	12
5.5. Nëpunësit e Shërbimit Publik.....	12
6. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	13
7. Zyra e Prokurimit	14
8. Zyra e Përfaqësuesit Ligjor	14
8.1. Të dhëna të përgjithshme:.....	15
8.2. Lëndët më të shpeshta dhe përfaqësimi në gjykatë:	15
8.3. Bashkëpunim ndërinstitucional.....	15
RAPORTI PUNËS SIPAS DREJTORIVE	15
1. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave	15
1.1. Sektori për buxhet dhe thesar	16
1.2. Sektori i financave.....	16
1.2.1. Të hyrat vetanake komunale sipas drejtorive për periudhën Janar – 11 Qershor 2026.....	16
1.2.2. Raporti i shpenzimeve sipas kategorive – Janar – 11 Qershor 2026.....	17
1.3. Qendra komunale për biznese	17
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike	18
3. Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës.....	26
3.1. Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave	27

3.2. Kultura dhe Mjedisi.....	27
3.3. Mësimdhënia dhe mësimnxënia.....	28
3.4. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja	28
3.5. Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve	29
3.6. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxëniet në shkolla - Fuqizimi i aktiviteteve profesionale në shkolla me mbështetje profesionale	29
3.7. Të dhënat statistikore	30
3.8. Aktivitetet	32
3.9. Trajnime, punëtori dhe punë në ekip.....	32
3.10. Infrastruktura në shkollat e Komunës së Prizrenit	33
4. Drejtoria e Shëndetësisë	36
5. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.....	38
6. Drejtoria e Inspektorateve	39
6.1. Inspektoriati Komunal.....	39
6.2. Inspektoriati i Tregut.....	41
6.3. Inspektoriati i Ndërtimit.....	42
7. Drejtoria e Administratës.....	43
7.1.Spektori për Mbështetje dhe Logjistikë.....	44
7.2. Arkiva dhe shërbimet juridike	44
7.3. Spektori i Teknologjisë Informative	45
7.4. Spektori i Gjendjes Civile	46
7.5. Spektori i Shërbimeve me Qytetarë.....	47
7.6. Zyra ekspeditive KK Prizren	47
8. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit.....	48
9. Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	49
9.1. Qendra për Punë Sociale	51
10. Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik	53
11. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	54
12. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	56
13. Drejtoria e Pronës dhe Çështjeve Ligjore	57
14. Drejtoria e Tatimit në Pronë.....	58
15. Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri	58
Raport mbi shpenzimet dhe investimet e Kompanisë “KAMILA” Sh.P.K.	59
Raport mbi shpenzimet dhe investimet e Kompanisë “FATONI 1” Sh.P.K.....	59

Kryetari i Komunës – fjalë hyrëse

Qytetarë të nderuar,

Anëtarë të Kuvendit Komunal,

Bashkëpunëtorë dhe partnerë të Komunës së Prizrenit,

Raporti gjashtëmujor që keni para jush paraqet një pasqyrë të punës së realizuar gjatë periudhës janar–qershor 2026. Ai është dëshmi e angazhimit të vazhdueshëm të institucioneve komunale për të ndërtuar një administratë më efikase, më transparente dhe më pranë qytetarëve, duke u fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm të Prizrenit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për secilin banor.

Gjatë këtij gjashtëmujori kemi vazhduar të punojmë me përkushtim në realizimin e projekteve zhvillimore, përmirësimin e infrastrukturës, avancimin e shërbimeve publike, mbështetjen e arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik. Çdo investim dhe çdo vendim ka pasur një objektiv të qartë: krijimin e kushteve më të mira për jetën dhe perspektivën e qytetarëve tanë.

Njëkohësisht, kemi vazhduar të forcojmë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, organizatat vendore dhe sektorin privat, duke krijuar mundësi të reja për realizimin e projekteve me interes publik dhe për zhvillimin afatgjatë të komunës sonë.

Transparenca, llogaridhënia dhe komunikimi i hapur me qytetarët mbeten vlera themelore të qeverisjes sonë. Besojmë se një institucion i fortë ndërtohet mbi besimin e qytetarëve dhe mbi gatishmërinë për të dëgjuar, për të bashkëpunuar dhe për të dhënë llogari për çdo vendim dhe çdo veprim.

Ky raport paraqet rezultatet e punës së përbashkët të administratës komunale, drejtorive dhe të gjithë zyrtarëve publikë, të cilët me profesionalizëm dhe përkushtim kanë kontribuar në realizimin e objektivave tona. Natyrisht, mbeten ende sfida dhe punë për të bërë, por rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe na japin besim se po ecim në drejtimin e duhur.

Falënderoj të gjithë qytetarët për besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe të gjithë punonjësit e administratës komunale, partnerët dhe bashkëpunëtorët që kanë dhënë kontributin e tyre në këto arritje. Me të njëjtin përkushtim do të vazhdojmë të punojmë për një Prizren më modern, më të zhvilluar dhe me më shumë mundësi për të gjithë.

Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit



Takimet dhe aktivitetet e Kryetarit

Vazhdojmë t'i takojmë qytetarët, OJQ-të, mediat, institucionet publike e ambasadat. Me të gjithë kemi krijuar marrëdhënie të mira dhe korrekte. Gjatë gjithë këtyre viteve kemi pritur OJQ, ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve diplomatike me të cilët kemi zhvilluar projekte dhe kemi bashkëpunim për ta zhvilluar kulturën, sportin, ambientin dhe projekte në sfera të ndryshme.

Kemi pasur takime dhe pritje në zyre të shumë organizatave joqeveritare, personaliteteve të shquara, të institucioneve vendore e të huaja dhe delegacione të ndryshme vendore, ndërkombëtare e diplomatike.





Përveç takimeve të lartcekura, gjithashtu janë mbajtur edhe shumë takime me shoqata të ndryshme, klube sportive, takime me KFOR-in, pjesëmarrje në tryeza me ftesë nga niveli qendror apo lokal, përzurime të investimeve kapitale në Prizren, pjesëmarrje në shumë aktivitete, takime individuale me qytetarë.

Memorandumet e nënshkuara gjatë 6-të mujorit të parë Janar-Qershor 2026 janë:

MoU Janar-Qershor 2026

Shtojcë nr.1 e marrëveshjes për bashkëfinancim të projektit mes MAPL-së, Komunës së Prizrenit dhe Helvetas Swiss Intercooperation për pjesëmarrje në Grantin e Performancës.

Memorandum bashkëpunimi mes Komunës së Prizrenit dhe Preda Plus, Integra

Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe OJQ “Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug” (AZHR Jug)

Marrëveshje bashkëfinancimi ndërmjet Komunës së Prizrenit, ITP-së dhe Makerspace

Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Prizrenit dhe IKAF-it

Amandament i I-rë me FKEE dhe Komunës së Prizrenit

Memorandum Mirëkuptimi mes MASHT-it dhe Komunës së Prizrenit

Memorandum Mirëkuptimi mes The Albanian American Foundation dhe Komunës së Prizrenit

Marrëveshje e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit mes MZHR-së dhe Komunës së Prizrenit

Marrëveshje shërbimi për shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura me Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “Gjakova” SH.A.



Projekti GRCFW2 – Rritja e Eficiencës së Energjisë në Objektet Publike

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Komuna e Prizrenit ka vazhduar angazhimin në zbatimin e projektit GRCFW2 Prizren Public Buildings Project, një ndër projektet më të rëndësishme për rritjen e eficiencës së energjisë dhe përmirësimin e infrastrukturës publike në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Projekti përfshin gjithsej 43 objekte publike, duke synuar uljen e konsumit të energjisë, përmirësimin e kushteve të punës dhe mësimi, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Gjatë këtij gjashtëmujori janë zhvilluar punimet në një numër të konsiderueshëm objektesh, ndërsa për objektet e tjera janë përfunduar procedurat për sigurimin e lejeve ndërtimore ose janë ndërmarrë përgatitjet për fillimin e punimeve. Punimet janë zhvilluar në objekte të rëndësishme, si: QMF Hoqë e Qytetit, QMF Reçan, AMF Planejë, AMF Billushë, AMBULANTA-DOBrusht, AMF Lybeqevë, AMF Poslisht, AMF Medvec, AMF Kraj, AMF Kushnin, SHFMU “Zef Lush Marku” Caparc, SHFMU “Pjetër Budi” Lubizhdë e Hasit, SHFMU “Zenun Çoçaj” Tupec, SHFMU “Nazim Buduri” Jeshkovë, SHFMU “Nazim Buduri” Hoqë e Qytetit, SHFMU “25 Maji” Lubinjë e Poshtme, SHFMU “Dëshmorët e Kabashit” Korishë, SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” Zhur, Gjimnazi “Remzi Ademaj” Velezhë, si dhe Shkolla Fillore “Svjetlost”. Në të njëjtën kohë, për disa objekte të tjera janë siguruar lejet komunale, duke krijuar kushtet për fillimin e punimeve në fazën pasuese të projektit.

Punimet e realizuara deri më tani kanë përfshirë rinovimin e kulmeve, hidroizolimin, izolimin termik të fasadave, zëvendësimin e dritareve dhe dyerve, instalimet elektrike dhe mekanike, përmirësimin e sistemeve të ngrohjes, si dhe masa të tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e eficiencës energjetike dhe jetëgjatësisë së objekteve publike. Në disa objekte, progresi i realizimit ka arritur në fazë të avancuar, duke iu afruar përfundimit të punimeve.

Komuna e Prizrenit ka vazhduar koordinimin e ngushtë me institucionet përgjegjëse dhe me kontraktorin zbatues për të garantuar zhvillimin e projektit sipas planifikimit, duke përsheptuar procedurat administrative dhe duke mbështetur realizimin e investimeve që do të përmirësojnë standardin e infrastrukturës publike dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët në të gjithë territorin e komunës.

RAPORTET E PUNËS SË ZYREVE TË KRYETARIT

1. Zyra e Auditimit të Brendshëm

Për periudhën Janar - Qershor 2026, deri në kohën e përgatitjes së këtij raportit (10 qershor), janë finalizuar dy raporte për detyra audituese, një raport për rishikimin e rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm, një raport për rishikimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe një detyrë audituese është në proces.

Janë realizuar këto detyra audituese:

1. Raporti mbi rishikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB për vitin 2025, është dhënë një (1) rekomandim;
2. Përgatitja dhe dorëzimi i raportit vjetor për kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe NjQHAB/MFPT - Periudha e raportimit: janar 2026;
3. Auditimi i Performancës - Subvencionimi me mekanizëm Bujqësor 2024-2025, janë dhënë tri (3) rekomandime;
4. Auditimi i obligimeve të papaguara për periudhën janar-mars 2026 dhe viti 2025, janë dhënë dy (2) rekomandime;
5. Rregullsitë e procesit të planifikimit dhe arkëtimi i të hyrave nga tatimi në pronë, **është në proces-pritet të përfundoj më 30 qershor 2026.**

Gjithashtu në kuadër të objektivave të përcaktuara, NjAB ka realizuar edhe këto aktivitete audituese:

- Bashkërendimi i auditimit me ekipin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)**, për auditimin e pasqyrave financiare të Komunës për vitin 2025 (periudha e auditimit: shkurt – maj 2026);
- Koordinimi i aktivitete lidhur me përgatitjen e raportit për periudhën e II mbi ecurinë e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)**, periudha e raportimit: mars 2026.
- Mbajtja e takimeve të rregullta me komitetin e auditimit:** Për periudhën në fjalë janë mbajtur dy (2) takime.
- Mbajtja e takimeve dhe punëtorive në Projektin IKAF dhe NjQHAB** dhe aktivitete këshilluese për drejtorët dhe zyrtarët komunalë.

2. Zyra për Integritim Evropian

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026 është bërë sigurimi i implementimit për zbatimin e obligimeve të Komunës nga Agjenda Evropiane për veprimet që ndërlidhen me Komunën dhe raportimi sipas kërkesave të MAPL-së.

Sipas kërkesës së MAPL-së janë mbledhur të gjitha informatat e kërkuara nga secila drejtori në lidhje me zbatimin e obligimeve të Komunës nga Agjenda Evropiane 2025 për PKZMSA (Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit).

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për Integritim Evropian ka realizuar aktivitete në kuadër të projekteve dhe proceseve të integritetit evropian. Është angazhuar në zbatimin dhe koordinimin e projekteve të mbështetura nga partnerë ndërkombëtarë, përfshirë projektet e Këshillit të Evropës për forcimin e qeverisjes në shumë nivele dhe demokracisë me pjesëmarrje, si dhe projektin HER FUTURE për fuqizimin e grave sipërmarrëse në Kosovë.

Është përfshirë edhe në projektin EMPOWERED, që synon përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal.

Gjatë kësaj periudhe, përfaqësuesit e zyrës kanë qenë anëtarë aktivë të Komisionit Komunal për Riintegrim, Kolegjiumit për Integritim Evropian dhe grupeve punuese për hartimin e planeve dhe rregulloreve komunale. Gjithashtu, kanë marrë pjesë në sesione informuese lidhur me programet dhe thirrjet e Bashkimit Evropian.

3. Zyra për Informim

Njësia për Komunikim me Publikun siguron informimin e rregullt dhe të saktë të qytetarëve, mediave dhe palëve të interesuara lidhur me aktivitetet, vendimet dhe politikat e institucionit, duke promovuar parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse.

Gjatë muajve Janar-Qershor 2026 ka ruajtur me kujdes të shtuar profesionalizmin, etikën dhe integritetin në informimin e publikut dhe zbardhjen e të gjitha dokumenteve që ka hartuar kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe të gjitha zyrat tjera administrative.

Njoftimet, thirrjet, vendimet dhe dokumentet tjera janë lekturuar dhe përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës sonë (shqip, boshnjakisht, turqisht dhe romisht), brenda afateve ligjore janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës dhe platformat tjera sociale.

Gjithashtu Njësia për Komunikim me Publikun ka bartur organizimin profesional e ligjor të konsultimeve publike për dokumentet e hartuara nga kryetari i komunës, kuvendi dhe të gjitha drejtoritë komunale. Poashtu, kemi organizuar 2 takime publike me qytetarë, 3 konsultime publike me qytetarë.

Njësia për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2026, ka pranuar 75 kërkesa për qasje në dokumente publike. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar në afat ligjor dhe dokumentet e kërkuara u janë ofruar palëve kërkuuese.

3.1. Publikimi i dokumenteve:

- Publikimi i Vendimeve të Kryetarit;
- Publikimi i Vendimeve të Kuvendit Komunal;
- Publikimi i Raportit periodik financiar për vitin 2026;
- Publikimi me kohë i lajmeve;
- Publikimi me kohë i njoftimeve të rëndësishme për qytetarët;
- Publikimi me kohë i thirrjeve për aplikime për subvencione dhe bursa;
- Publikimi me kohë i ftesave për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Komunitete.

3.2. Hartimi i dokumenteve:

- Plan i punës së Njesisë për Komunikim me Publikun për vitin 2026;
- Përgatitja dhe miratimi në Kuvend Komunal i Planit të Veprimit për Transparencë për vitet 2026-2030;
- Hartimi i planit të detajuar për organizimin e dëgjimeve buxhetore që do të mbahen gjatë vitit 2026 për buxhetin e vitit 2027;
- Hartimi i kalendarit për organizimin e dëgjimeve buxhetore që do të mbahen gjatë vitit 2026 për buxhetin e vitit 2027;
- Plotësimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me transparencë, performancë dhe transparencë buxhetore.

Plotësimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me transparencë, performancë dhe transparencë buxhetore:

- Plotësimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me transparencë dhe llogaridhënie;

- Plotësimi me të dhëna në sistem që kanë të bëjnë me performancë komunale për vitin 2025, kjo matje bëhet nga MAPL-ja dhe donatorët;
- Plotësimi me të dhëna që kanë të bëjnë me Pyetësin për Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2025, kjo matje bëhet nga Instituti GAP.

Vazhdojmë ta mbajmë të hapur linjën telefonike të thirrjeve pa pagesë për qytetarët e komunës sonë dhe të gjitha pyetjet, kërkesat dhe sugjerimet e tyre adresohen për zgjidhje në zyrat përkatëse.

4. Zyra Ligjore

Zyra ligjore po bën sigurimin e shërbimeve juridike dhe këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale si dhe hartimi dhe shqyrtimi i legjislacionit sekondar duke përfshirë:

- Kërkesa për hartimin e vendimeve,
- Opinione ligjore për Zyrën e Kryetarit, për drejtoritë dhe sektorët e tjerë sipas kërkesave të tyre,
- Kërkesa për Përfaqësim Ligjor të Komunës pranë organeve Gjyqësore,
- Përpilimi i të gjitha shkresave (sipas kërkesave), të nevojshme brenda afateve ligjore,
- Mbajtja, evidentimi i lëndëve si dhe arkivimi i tyre,
- Përcjellja e shkresave dhe akteve në drejtoritë komunale dhe organeve të tjera.

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar dhe janë proceduar për nënshkrim të Zyra e Kryetarit të Komunës në total 182 vendime 6 autorizime deri më 15.06.2026.

- Gjatë muajit janar janë marrë.....32 vendime dhe 2 autorizime,
- Gjatë muajit shkurt janë marrë.....32 vendime dhe 0 autorizime,
- Gjatë muajit mars janë marrë.....49 vendime dhe 1 autorizim,
- Gjatë muajit prill janë marrë.....31 vendime dhe 2 autorizime,
- Gjatë muajit maj janë marrë.....29 vendime dhe 0 autorizime,
- Gjatë muajit qershor janë marrë.....9 vendime dhe 1 autorizim.

5. Zyra e Burimeve Njerëzore

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore gjatë kësaj periudhe ka realizuar aktivitetet dhe detyrat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, procedurat administrative dhe nevojat e institucionit. Në vijim paraqiten të dhënat statistikore dhe aktivitetet kryesore të realizuara:

5.1. Trajtimi i lëndëve dhe komunikimeve zyrtare

- Përmes sistemit Intranet janë pranuar gjithsej 186 kërkesa, të cilat janë shqyrtuar, ndërsa një pjesë e tyre vazhdojnë të jenë në procedurë administrative.
- Janë trajtuar gjithsej 3023 kërkesa, shkresa dhe komunikime elektronike.
- Numri i përgjigjeve të përgatitura dhe të dërguara ndaj kërkesave të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) është 23.

5.2. Administrimi i dosjeve dhe sistemit HRMIS

- Janë përditësuar dhe shqyrtuar 247 dosje personale të shërbyesve civil në sistemin HRMIS si dhe janë formuar 94 dosje personale për nëpunës të shërbimit publik.

5.3. Menaxhimi i marrëdhënieve të punës

- Është menaxhuar procesi i vlerësimit të performancës për të gjithë shërbyesit civil të Administratës Komunale, Nëpunësit e shërbimit publik, Krijuesit dhe performuesit e artit dhe kulturës, Nëpunësit teknikë dhe mbështetës.
- Janë përpiluar 57 kontrata pune për shërbyes publikë.
- Janë hartuar dhe proceduar vendime administrative që kanë të bëjnë me transferime, emërimë si ushtrues detyre, vendime për shtesa funksionale, pushime pa pagesë, pezullime, pensionime, si dhe vërtetime sipas kërkesave për të gjithë zyrtarët publikë të Komunës së Prizrenit.

5.4. Konkursset e proceduara

- Nëpunësit e Shërbimit Civil
- Gjatë periudhës raportuese janë shpallur gjithsej 4 (katër) konkurse, me 8 (tetë) vende të lira pune, si më poshtë:
- 4 (katër) konkurse për pranim në shërbimin civil, të cilat aktualisht ndodhen në procedurë zhvillimi.

5.5. Nëpunësit e Shërbimit Publik

Gjatë periudhës raportuese është shpallur 1 konkurs me 1 vend të lirë pune, si vijon:

- Krijues/e dhe Performues/e i/e Artit dhe Kulturës – 1 konkurs, i cili është përfunduar me sukses.

6. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

ZKKK-ja, sipas Planit të Punës për vitin 2026, ka punuar në përpilimin e kërkesave për thirrjen publike për ndarje të subvencioneve dhe transfereve për persona fizikë për furnizim me dru për ngrohje si dhe pako ushqimore e higjienike për familjet në nevojë nga radhët e komuniteteve minoritare, duke u bazuar në rregulloren komunale për kushte, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve.

Aktivitetet kryesore:

- ZKKK-ja, në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare “Bereqeti” ka bërë shpërndarjen e pakove ushqimore për 140 familje nga komunitetet minoritare me rastin e muajit të shenjtë të Ramazanit dhe festës së Bajramit.
- Gjatë periudhës raportuese, ZKKK-ja ka pranuar dy kërkesa për kthimin e personave të zhvendosur nga regjioni.
- Riintegrimi i personave të riatdhesuar dhe integrimi i të huajve - Gjatë periudhës raportuese, ZKKK-ja ka pranuar gjithsej 10 kërkesa, prej të cilave: 6 kërkesa për vazhdim të akomodimit, 2 kërkesa për akomodim për herë të parë, ku një person është akomoduar nga DRPRIH, 1 kërkesë për renovim të shtëpisë, 1 kërkesë për vazhdim të akomodimit për të huaj nga vendet e konfliktit.
- Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur katër takime të Komitetit Komunal për Riintegrim (KKR), ku janë shqyrtuar gjashtë kërkesa për vazhdim të akomodimit dhe një kërkesë për renovim të shtëpisë.
- Sipas marrëveshjeve të Komunës, ZKKK-ja vazhdon bashkëpunimin me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, si: OSCE, UNHCR, UNMIK, IOM, AT, etj.
- ZKKK-ja ka lëshuar 204 vërtetime për shërim jashtë vendit.
- ZKKK-ja rregullisht viziton dhe mban kontakte me komunitetet në terren, përcjellë ngjarjet kulturore dhe fetare, merr pjesë në trajnime, punëtori, konferenca, komisione dhe aktivitete të tjera, bashkëpunon ngushtë edhe me drejtoritë komunale.

7. Zyra e Prokurimit

Zyra e prokurimit ka zhvilluar këto aktivitete në kuadër të punëve dhe detyrave të punës në periudhën Janar-Qershor 2026:

1. Janë iniciuar gjithsej 25 procedura të prokurimit në të cilat përfshihen: punë, shërbime dhe furnizime të vlerave të vogla, të mesme dhe të mëdha si dhe janë zhvilluar 12 procedura të vlerave minimale dhe janë nënshkruar 12 kontrata me procedura minimale (furnizime dhe shërbime)
2. Janë nënshkruar 24 kontrata, prej tyre:
 - 7 kontrata janë të vitit fiskal 2026 dhe 16 kontrata të procedurave të vitit 2025 (dhe një kontratë e vitit fiskal 2024)
 - 36 kontratat e nënshkruara janë të vlerave minimale, vlerave të vogla, vlerave të mesme dhe vlerave të mëdha e në të cilat përfshihen: punë shërbime furnizime dhe konkurse projektimi si dhe janë vlera të procedurave njëburimore pa publikim të njoftimit për kontratë.
 - Vlera totale e kontratave të nënshkruara për vitin fiskal 2026 deri më 02.06.2026 është 120.312.60 €
 - Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal 2026 janë dërguar gjithsej 4 kërkesa për rishqyrtim.
3. Janë ngritë në sistem 4 vendime të autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesat për rishqyrtim të OE.
4. Në procedurat e prokurimit për vitin fiskal 2026 është parashtruar 1 ankesë, për vendim të OSHP-së për procedim të mëtejshëm.

Zyra e prokurimit gjegjësisht zyrtarët e kësaj zyreje kanë kryer edhe punë dhe detyra të punës të cilat i ngarkohen me ligj dhe me përshkrim të detyrave të punës.

8. Zyra e Përfaqësuesit Ligjor

Zyra e Përfaqësuesit Ligjor në kuadër të Komunës së Prizrenit, si detyrë kryesore ka përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesit të Komunës dhe të instituconeve që financohen nga Komuna, në procedurë civile, përmbartuese dhe administrative në të gjitha nivelet e gjyqësorit të vendit. Ky raport përmbledh të dhëna statistikore të punës së kësaj Zyreje për periudhën Janar-Qeshor 2026 dhe synon të japë një pasqyrë të qartë mbi angazhimet dhe ecurinë ligjore të Zyrës.

8.1. Të dhëna të përgjithshme:

-Lëndë të reja të pranuar për procedim: 184 lëndë

8.2. Lëndët më të shpeshta dhe përfaqësimi në gjykatë:

- Kompensim i palujtshmërisë
- Vërtetim i pronësisë
- Kontest nga mardhënia e punës
- Pengim posedim
- Kompensim dëmi
- Anulim i vendimeve, etj.

Përgjigje të përgaditura ndaj padive: 110 sosh

Seanca gjyqësore të përfaqësuara nga Zyra: 342 seanca

Akte të ndryshme të përgaditura: 40 sosh

Ankesa të ushtruara nga Zyra në gjykata kompetente: 14

Mjete të jashtëzakonshme juridike të ushtruara në Gjykatën Supreme: 5

8.3. Bashkëpunim ndërinstitutional

Kërkesa të brendshme dhe aktpërcjellës të adresuar në Zyrat përgjegjëse dhe drejtoritë komunale: rreth 50.

RAPORTI PUNËS SIPAS DREJTORIVE

1. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave

Drejtoria për Ekonomi e Financa përbëhet nga 3 (tre) sektorë:

1. Sektori për buxhet dhe thesar
2. Sektori i financave
3. Qendra komunale për biznese

1.1. Sektori për buxhet dhe thesar

Sektori për Buxhet dhe Thesar gjatë periudhës Janar – 11 Qershor 2026 ka ekzekutuar pagesat për 1433 lëndë, po ashtu ka bërë zotimin e 628 lëndëve. Po në të njejtën kohë për 901 lëndë ka bërë pranimin e mallit në sistem dhe ka bërë aprovimin e lëndëve për mjetet e zotura për 604 lëndë.

BUXHET DHE THESAR – JANAR – 11 QERSHOR 2026	
Pagesat e ekzekutuara	1433
Zotimet e bëra për pagesë	628
Pranimi i mallit në SIMFK	901
Aprovimi i lëndëve për mjetet e zotura dhe të pranimit të mallit	604

1.2. Sektori i financave

1.2.1. Të hyrat vetanake komunale sipas drejtorive për periudhën Janar – 11 Qershor 2026

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar – 11 Qershor 2026 është siç shihet edhe në tabelën e prezentuar më poshtë: Për vitin 2025 janë planifikuar të hyra **11,365,868.00 €** kurse për këtë periudhë janë mbledhur të hyra vetanake **4,053,722.85 €** apo **35.66 %** nga planifikimi.

Kodi	Drejtoritë	Planifikimi	Të Hyrat	Diferenca	Indexi
16310	Administrata dhe Personeli	420,000.00	157,713.78	-262,286.22	37.55%
16619	Inspeksioni	15,000.00	9,191.20	-5,808.80	61.27%
17510	Ekonomi, Financa dhe Zhvillim	3,200,000.00	1,264,271.34	-1,935,728.66	39.50%
18010	Shërbime Publike, Mbrojtje civile, Emergjencia	4,285,000.00	1,202,213.78	-3,082,786.22	28.05%
47010	Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	0.00	12,153.68	12,153.68	0.00%
65050	Kadastër dhe Gjeodezi	380,868.00	113,884.04	-266,983.96	29.90%
66055	Planifikim Urban dhe Mjedis	2,355,000.00	1,032,970.78	-1,322,029.22	43.86%
73600	Shërbimet e kujdesit primar Shëndetësor	230,000.00	104,458.05	-125,541.95	45.41%
85010	Kulturë, Rini, Sport	10,000.00	2,223.20	-7,776.80	22.23%
92050	Arsimi dhe Shkenca - Administrata	470,000.00	154,643.00	-315,357.00	22.90%
	Gjithsej:	11,365,868.00	4,053,722.85	-7,312,145.15	35.66%

1.2.2.Raporti i shpenzimeve sipas kategorive – Janar – 11 Qershor 2026

Komuna e Prizrenit - Drejtoria për Buxhet dhe Financa				
Shpenzimet sipas Kategorive	periudha 01.01.2026-11.06.2026			
Kategoria	Planifikimi	Shpenzimet	Diferenca	Indexi (%)
Pagat	31,385,777.03	15,356,483.65	-16,029,293.38	48.92%
Mallrat dhe Shërbimet	14,524,423.14	9,366,411.92	-5,158,011.22	64.48%
Shpenzimet Komunale	1,069,493.00	537,031.09	-532,461.91	50.21%
Subvencionet	5,567,238.48	1,516,309.66	-4,050,928.82	27.23%
Shpenzimet Kapitale	22,893,273.29	16,273,554.94	-6,619,718.35	71.84%
Gjithsej:	75,440,204.94	43,049,791.26	-32,390,413.68	57.06%

1.3.Qendra komunale për biznese

Gjatë periudhës Janar – 11 Qershor 2026 Qendra për Regjistrimin e Bizneseve ka kryer këto punë:

Regjistrime të reja	493
Ndryshimet	293
Shuarjet	40
Rez. Emrit	/
Informatat e biznesit	338
Njoftim mbi shuarjen	1
Historiku	2
Duplikat	37
Vërtetime	22
Tjera	/
Ndërrim certifikate (NUI)	28
Gjithsej shërbime:	1,254

2. Drejtoria e Shërbimeve Publike

Drejtoria për Shërbime Publike, gjatë vitit 2026, bazuar në planifikimin buxhetor dhe planin e punës, ka paraparë realizimin e një numri të konsiderueshëm projektesh të reja (rreth 20 projekte), përveç projekteve ekzistuese që janë në implementim, përkatësisht rreth 60 projekte që vazhdojnë nga vitet paraprake.

Për vitin 2026, Komuna jonë, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike, ka planifikuar buxhet për investime kapitale në vlerë prej **14,007,059 €**, nga të cilat **12,725,670 €** sigurohen nga granti qeveritar, ndërsa **1,281,389 €** nga të hyrat vetanake.

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime (M&SH), për Drejtorinë tonë është paraparë një buxhet në vlerë prej **5,393,476 €**.

Përveç këtij buxheti, nga të hyrat e bartura nga viti 2025, Drejtoria jonë ka përfituar fonde shtesë në vlerë prej **1,000,000 €**. Nga ky fond pritet të financohen 3 projekte, ku pjesa më e madhe e mjeteve do të përdoret për mbulimin e obligimeve kontraktuale.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria për Shërbime Publike ka nënshkruar 3 kontrata të reja në vlerë prej **3,800,000 €**. Gjithashtu, janë marrë 10 vendime për fillimin e procedurave të prokurimit dhe implementimit të projekteve kapitale. Deri në fund të vitit pritet të nënshkruhen edhe disa kontrata të reja.

Në periudhën Janar – Qershor, për investime kapitale janë shpenzuar gjithsej **12,073,836.46 €** në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale, **3,271,811.31 €** në kategorinë Mallra dhe Shërbime si dhe **197,587.45 €** për shpenzime komunale.

Disa prej projekteve që janë në realizim e sipër:

- 1. Ndërtimi, riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt në Komunën e Prizrenit – projekt trevjeçar**, ku gjatë gjashtëmujorit të parë 2026 janë realizuar punimet e mëposhtme:
 - Rehabilitimi i rrugës Xhemë Gostivari – shtrim i shtresave të asfaltit dhe përgatitja e sipërfaqes;

- Rehabilitimi i rrugës Xhevë Lladrovci – punime të plota asfaltimi;
- Ndërtimi i rreth-rrotullimit në lagjen Dardania II – punime të infrastrukturës rrugore dhe sinjalistikës;
- Rehabilitimi i gropave nëpër qytet: Transit, Ortakoll, Dardania II, fshati Gjonaj, lagjja Bajram Curri dhe lokacione të tjera.

2. Ndërtimi i Infrastrukturës në Tupec:

- Punime në rrugë lokale të fshatit Tupec – ndërtimi i akseve rrugore me elemente betoni;
- Ndërtimi i një pjese të rrjetit të kanalizimit fekal – tubacione, grilat dhe puseta;
- Projekti trevjeçar po vazhdon sipas planit dinamik.

3. Instalimi dhe riparimi i ndriçimit publik në lagjet Ortakoll, Bajram Curri, Tusus, Arbanë, Jeta e Re dhe fshatrat: Piranë, Zhur, Hoqë e Qytetit dhe lokalitete të tjera.

- Ka përfunduar auditimi i ndriçimit për rrugët ku do të vendosen dritat “Smart”, duke përfshirë simulimin përmes Dialux dhe matjet me luxmetër;
- Ka filluar zbatimin e masave të efikasitetit energjetik (EE) në rrugët e qytetit;
- Rregullimi i plotë i ndriçimit publik në rrugët: Ismail Kryeziu, Rustë Kabashi dhe Ekrem Rexha;
- Zëvendësimi i komplet kabllove energjetike në tri rrugët e lartpërmendura, të dëmtuara si pasojë e aksidenteve të shumta në komunikacion;
- Instalimi i shtyllave të reja të ndriçimit publik ku kishin munguar si pasojë e aksidenteve.

4. Mirëmbajtja e ndriçimit publik – Kontratë kornizë trevjeçare:

- Ndërrimi dhe zëvendësimi i dritave jofunksionale në rrugë dhe zona publike;
- Largimi i shtyllave të dëmtuara dhe sanimi i defekteve pas aksidenteve të komunikacionit;
- Intervenime emergjente në linjat e ndriçimit publik nëpër rrugët e ndryshme të qytetit dhe fshatrave.

NDRIÇUES LED 149 të zëvendësuara	KABLO ENERGJETIKE 4,080 m të shtrira	PARKU DARDANIA 10 drita të reja LED
--	--	---

5. Ndërtimi i Ujësjellësit dhe Rezervuarit – Fshati Lubizhdë:

Të gjitha punët kanë përfunduar – ujësjellësi dhe dy rezervuarët janë ndërtuar. Aktualisht janë duke u kryer testimet finale para kyçjes në rrjetin e fshatit.

6. Rekonstruimi i rrugës Reçan – Lubinje e Epërme – Lubinje e Poshtme, projekt trevjeçar

Plani dinamik është duke u zbatuar konform projektit - ka përfunduar grryerja e asfaltit ekzistues, mbushja dhe ngjeshja me material guror (0-150, 0-63, 0-31) mm, shtrirje e gjeotekstilit, asfaltimi (shtresa e parë 9 cm, BA-31), shpimi dhe mbushja e pilotave rezistente ndaj rrëshqitjeve.

7. Rehabilitimi i Ujësjiellit – Fshati Zhur

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto punime:

- Hapja e kanaleve dhe transporti i materialit të gërmuar deri në deponi;
- Furnizimi, transporti, saldimi dhe vendosja e gypave në kanal;
- Mbulimi i gypave me zhavorr sipas specifikimeve teknike;
- Eliminimi dhe riparimi i defekteve të hasura gjatë hapjes së kanaleve;
- Kthimi i sipërfaqeve rrugore në gjendjen e mëparshme.

8. Rehabilitimi i Rrugëve me Kubëza Betoni

Përqindja e punimeve të kryera sipas Situacioneve (1, 2, 3 dhe 4) është: **49.78%**.

9. Mirëmbajtja e Kanalizimit dhe Ujësjiellit – Qyteti dhe Fshatrat

Punët të kryera janë: Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve, vendosja e shenjave sinjalizuese, evindentimi i instalimeve nëntokësore, pastrimi i terrenit, largimi i kubëzave, gërmimi i kanalit me makinë dhe me dorë. Vendosja e shiritit sinjalizues, demolimi i gypave ekzistues, shtrirja e zhavorit dhe nivelizimi në trase, vendosja e gypave dhe montimi i tyre, mbulimi i gypave me zhavorr, ndërtimi i puseta, kyqja e lidhjeve të reja në puseta, shtrirja e zhavorit në trase dhe kthimi i trasesë në gjendjen e mëparshme. Largimi i dheut të tepër të gërmuar deri në deponi, vendosja e kapakëve metalikë të peshave të rënda, nivelizimi i puseta aty ka pas nevojë, furnizim me kubëza dhe montimi i tyre, prerja e asfaltit, depërtimi i asfaltit me anë të shpimit, thyerja e betonit, furnizim me beton etj. Kanë përfunduar gjithsej 98% i punimeve.

10. Pastrimi i Puseta dhe Rrjetit të Kanalizimit

Lokacionet: Brenda qytetit (Bajram Curri, Ortakolli, Jeta e Re, Arbana, Tususi, Dardania, Kurrilla) dhe fshatrat e Prizrenit (Piranë, Zojz, Caparc, Medvec, Zhur, Vlashnjë, Korishë, Lubizhdë, Landovicë, Krushë, etj.).

11. Rehabilitimi i Kanalizimit – Shadërvan, Ortakoll, Bajram Curr

Punët e kryera janë: largimi i kubëzave dhe prerja e asfaltit, evindentimi i instalimeve nëntokësore, gërmimi i kanalizimit me makinë dhe me dorë, ngjeshja e dheut, vendosja e zhavorrit nën gypa, anash dhe mbi gypa deri në nivelin sipas nevojës ashtu si është përcaktuar me standarde, në ato pjesë ku ka kaluar rruga vendosja e zhavorrit është bërë deri në kuotën e rrugës, furnizimi, transporti, vendosja dhe

montimi i gypave (ujësjellësit dhe kanalizimit me diametër sipas paramasës), vendosja e dheut të tepërt të gjermuar në kanal si dhe transporti e largimi i dheut të tepërt të gjermuar deri në deponi, vendosja e kubëzave të larguara si dhe furnizimi me kubëza të reja, vendosja e shiritit sinjalizues si dhe furnizimi me beton dhe thyerja e betonëve aty ku ka qenë e nevojshme, ndërtimi i pusetave si dhe vendosja e kapakëve metalikë të peshave të rënda, krijimi i kyçjeve të reja etj. Ka përfunduar gjithsej 11.51% e punimeve.

12. Ndërtimi i Infrastrukturës – Fshati Vlashnjë, projekt trevjeçar

Punët e kryera janë: Identifikimi i instalimeve nëntokësore, gjermimi i kanalit me makinë dhe me dorë, planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gjermimit, zgjerimi dhe thellimi i vendeve ku do të vendosen pusetat, furnizimi, shtrirja dhe nivelizimi i shtresës së zhavorrit, furnizimi, transporti dhe montimi i gypave, mbulimi i gypave me zhavor, mbushja e kanalit me material guri dhe ngjeshja e tij, ndërtimi i pusetave dhe vendosja e kapakëve metalikë etj. Kanë përfunduar gjithsej 22.53% e punimeve.

13. Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit

Është punuar në gjermim, ndërtimin e murit mbrojtës, pastrimi i pjesëve anësore, vendosja e ujrëve, vendosja e skajoreve, rregullimi i një pjese të ndriçimit, vendosja e një pjese të shtëpizave nga druri, shtrirja e zhavorrit, gjelbërimi, mbjellja e pemëve si dhe e disa ulëseve dhe shportave. Projekti ka filluar në majin shtator 2025 dhe pritet të përfundojë brenda afatit kohor të parashikuar në kontratë (gusht 2026).

14. Ndërtimi i rrugës nga shkolla në Novoselan deri në Vërbiçan, projekt dyvjeçar

Punët që kanë përfunduar: Janë kryer punët e gjermimit, mbushjes me material mbushës si dhe është bërë ngjeshja e tij.

15. Zhvendosja e Objekteve Elektrike

Gjatë periudhës gjashtëmujore Janar–Qershor 2026 janë realizuar punimet në projektet e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i Projektit
1	Dislokimi dhe ndërtimi i rrjetit 0.4kV në lagjen Dardania 2
2	Dislokimi dhe ndërtimi i rrjetit 10/0.4kV te Tregu i Gjelbër
3	Dislokimi dhe ndërtimi i rrjetit 35kV në Prizren
4	Ndërtimi i infrastrukturës elektrike për Banesat Sociale në Petrovë
5	Vendosja e shtyllave të Parkut në Dardani (Jaglenicë) me punimet përcjellëse

- Punimet në rrjetin 0.4kV të lagjes Dardania 2 kanë siguruar furnizimin me energji elektrike të qëndrueshëm për familjet e kësaj lagjeje;
- Rregullimi i rrjetit 10/0.4kV të Tregu i Gjelbër ka rritur sigurinë dhe kapacitetin e furnizimit elektrik të zonës tregtare;
- Dislokimi i rrjetit 35kV në Prizren është realizuar në pajtim me kërkesat e zhvillimit urban;
- Infrastruktura elektrike për Banesat Sociale në Petrovë ka mundësuar lidhjen e banorëve me rrjetin elektrik;
- Shtyllat e Parkut në Dardani (Jaglenicë), me punimet e ndriçimit përcjellës, janë montuar me sukses.

16. Furnizim me Kablo të Tensionit të Mesëm

Kabëll i tensionit të mesëm i furnizuar në kuadër të kësaj kontrate është shfrytëzuar për realizimin e projekteve të njëjta infrastrukturore si në tabelën e lartëcekur, duke siguruar materialet e nevojshme.

17. Intervenimet Emergjente

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, kompania G-Project SH.P.K ka realizuar intervenime emergjente me makineri të rëndë në 14 lokacione të ndryshme në territorin e Komunës së Prizrenit (Randobravë, Velezhë, Kabash i Hasit, Gjonaj, Tusus, Leskovec, Hoçë e Qytetit, Jeshkovë, Landovicë, Tusus-Hoçë, Llokvicë, intervenime afër urës së autostradës – Nashec, Dardani (Jaglenicë), Kabash (intervenimi i dytë)). Intervenimet janë realizuar si pasojë e fatkeqësive natyrore (rrëshqitje dheu, përmbytje atmosferike, shembje të rrugëve) dhe për pastrimin e deponive ilegale dhe pastrim të hapësirave publike.

18. Ndërtimi i rrugës Shpenadi – Lubizhdë – Projekt Trevjeçar

Gjatë periudhës gjashtëmujore Janar – Qershor 2026, plani dinamik i kontratës është duke u zbatuar konform projektit. Janë realizuar fazat fillestare dhe paraprake të ndërtimit, të cilat krijojnë bazën e nevojshme për vazhdimin e punimeve kryesore.

- Incizimet gjeodezike në terren janë përfunduar – janë marrë të dhënat bazë për trasenë e plotë të rrugës;
- Pastrimi i komplet trasesë së rrugës – heqja e vegjetacionit, materialeve dhe pengesave;
- Punimet në bazamentin e rrugës – përgatitja e nënshtresës për asfalt;
- Gërmimi me makineri të rëndë – kryer sipas kuotave gjeodezike të projektit.

19. Furnizim me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara në Komunën e Prizrenit

Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2026 janë realizuar furnizime me zhavorr, sistemime dhe rimbushje të rrugëve të pa asfaltuara, hapje dhe pastrim të kanaleve atmosferike si dhe intervenime në lokacione të ndryshme sipas kërkesave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Punimet janë realizuar në rrugët:

- Rruga “Besim Shala” – Aksi 1 (L=1,045 m)
- Rruga “Besim Shala” – Aksi 2 (L=185 m)
- Rruga “Halim Bytyqi” (L=165 m)
- Rruga “Behamir Memaj” – Jeta e Re (L=520 m)
- Lagjja “Bajram Curri” (L=225 m)
- Rruga te ura e Nashecit (L=245 m)
- Korishë – te Ferma e Pulave (L=1,050 m)
- Gërçar (L=200 m)

Gjithashtu janë realizuar punime të pastrimit dhe rehabilitimit të rrugëve pas reshjeve dhe vërshimeve në fshatrat: Jeshkovë, Krajk, Mushnikovë, Leskovec dhe Lubinjë e Epërme.

Në kuadër të kontratës janë realizuar edhe punime në sistemimin e ujërave atmosferike. Aktualisht është në realizim kanal atmosferik në fshatin Hoçë e Qytetit, ku janë duke u ekzekutuar punimet në kanal të hapur me gjatësi rreth 60m dhe kanal të mbyllur me gjatësi rreth 90m.

Gjatësia e përgjithshme e rrugëve të trajtuara gjatë kësaj periudhe arrin rreth 3000m, me gjerësi mesatare prej 5.0 – 6.0m, ndërsa gjatësia totale e kanaleve atmosferike arrin rreth 150m.

20. Ndërtimi i rrugës alternative Skorrobisht-Lubizhdë

Ndërtimi i rrugës duke përfshirë instalimin e kanalizimit atmosferik dhe kanalizimit fekal në total 2.5km.

Punët që janë përfunduar: Ka përfunduar gërmimi i trasesë së rrugës, instalimi i 1000m kanalizim fekal si dhe 480m kanalizim atmosferik.

21. Rekonstruimi i rrugës Ekrem Rexha-Drini në fshatin Lubizhdë e Prizrenit

Rekonstruimi i rrugës duke përfshirë gjithë infrastrukturën nëntokësore, asfaltimin, trotualet si dhe ndriçimin.

Punët që janë përfunduar: Deri më tani 1500m kanë përfunduar të kanalizimit fekal si dhe atmosferik, demolimi i gjithë trasesë, kyçjet e banorëve si dhe mbushja me zhavorr për pjesën e demoluar.

22. Ndërtimi i infrastrukturë në Korishë - projekt dy vjeçar

Punimi i rrugëve, mureve mbrojtëse, trotuarëve, kanalizimeve atmosferike dhe kanalizimeve fekale. Gjithsej: 35 Akse.

23. Rregullimi i përrockës në Randobravë të Prizrenit, projekt dy vjeçar

Deri më tani janë realizuar punimet e pastrimit dhe përgatitjes së terrenit, punët e dheut, gërmimet për kanalizim dhe për trasenë e përrockës, mbushjet me zhavorr dhe ngjeshjet sipas kuotave gjeodezike si dhe një pjesë e konsiderueshme e punimeve të arnimit dhe betonimit të përrockës. Gjithashtu, janë kryer vazhdimisht punime shtesë për largimin e dheut të rrëshqitur, pastrimin e mbeturinave dhe eliminimin e pengesave të krijuara nga depozitimet e paautorizuara në zonën e punimeve.

24. Ndërtimi i rrugëve, kanalizimit dhe ndriçimit publik në fshatin Krajk, projekt tre vjeçar

Në kuadër të këtij projekti janë kryer punime në aksin 18, akset 23, 24, aksin 25, aksin 26, akset 27 dhe 28. Në kuadër të këtyre akseve janë kryer punime në gërmim, mbushje me zhavorr si dhe është bërë kubëzimi i tyre.

25. Ndërtimi i tregut të gjelbër dhe parkingut nëntokësor në Prizren

Në gjashtëmujorin e fundit në ndërtimin e Tregut të Gjelbër janë realizuar këto punime: Pas betonimit të themelpalakës kemi vazhduar me punimet përcjellëse të objektit sipas detajeve të projektit ku fillimisht kemi bërë muratimin perimetral me blloka të betonit në mënyrë që të krijohen kushte për aplikimin e hidroizolimit vertikal për muret e objektit. Hidroizolimi është bërë në dy zona sipas standardeve nga stafi i kualifikuar për kryerjen e këtyre punimeve. Furnizimi, transporti dhe montimi i armaturës për muret e betonit dhe shtyllat e objektit sipas detajeve të projektit. Para se të bëhet kallupimi i mureve kemi vendosur shiritin "waterstop" në aksin e mureve perimetrale në mënyrë që të krijohet mbrotje nga uji dhe të mos paraqiten probleme të lagështisë në të ardhmen. Furnizimi, transporti dhe betonimi i mureve dhe shtyllave sipas specifikave të projektit ku në vazhdimësi janë marrë edhe mostrat e betonit për kontrollimin e cilësisë. Zhvillimi i punimeve për formimin e platove mbi bodrum pasi që janë 3 nivele të pllakave dhe duhen të punohen veç e veç. Furnizimi, transporti, shtrierja dhe prerja e armaturës sipas detajeve të projektit për pllakën e objektit si dhe shtrierja e hidroinstalimeve dhe të gjitha instalimeve elektrike sipas detajeve të projektit.

Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakës mbi bodrum sipas specifikave të projektit. Po ashtu janë shtrirë edhe gypat e drenazhit rreth objektit sipas detajeve në projekt.

26. Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura, kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit

Në gjashtëmujorin e fundit janë realizuar këto punime në zonën e Shadërvanit:

- Zhvillimi i punimeve në Kej,
- Zhvillimi i punimeve për ndërtimin e murit përkaj Lumbardhit në segmentin: Ura e Gurit - Ura Arasta,
- Zhvillimi i punimeve për ngritjen e murit mbrojtës me kalldrëm në mënyrë që të krijohet hapësirë e sigurtë për qarkullim të këmbësorëve duke iu përmbajtur stilit dhe strukturës së zonës,
- Zhvillimi i punimeve për restaurimin e Urës së Kaltër,
- Zhvillimi i punimeve për hidroizolimimin e murit të Kishës në rrugën “Marin Barleti”,
- Zhvillimi i punimeve në degëzimin e rrugës “Marin Barleti”.

27. Hapja e rrugës pyjore “Udha e staneve” në Vermicë, projekt dy vjeçar

Plani dinamik është duke u zbatuar konform projektit, ku janë përfunduar shumica e gërmimeve.

28. Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen “2 Korriku” në Prizren, projekt dy vjeçar

Plani dinamik është duke u zbatuar konform projektit, deri më tani në një pjesë të aksit rrugor kanë përfunduar instalimet nëntokësore, ka përfunduar një pjesë e trotuarit si dhe shtresa e parë e asfaltit po në këtë aks.

29. Rregullimi i infrastrukturës dhe renovimi i objektit të Stacionit të Autobusëve në Prizren

30. Zhvillimi i databazës dhe sistemit Web Gis për Shërbime Publike në Komunën e Prizrenit - projekt tre vjeçar.

31. Revidimi i projekteve.

32. Ndërtimi i shtratit të Lumbardhit afër Kampusit Universitar në vazhdim të rrjedhës.

33. Mirëmbajtja e Zonave dhe Shërbimi i Mbeturinave

Ky raport financiar paraqet të gjitha transaksionet dhe statusin e pagesave për tri kontratat aktive të Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës së Prizrenit: kontratave publike dhe dy kontratat e

mirëmbajtjes së zonave (Zona I+II dhe Zona III) dhe kontrata e shërbimit të mbeturinave. Raporti mbulon periudhën e gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

VLERA TOTALE E PROJEKTEVE 4,979,301.64 €	TOTALI I FATURUAR 1,668,107.66 €	TOTALI I PAGUAR 1,344,244.23 €
--	--	--

34. Shërbimi i Grumbullimit të Mbeturinave – 2026 (Janar – Qershor)

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2026 janë regjistruar pagesat e mëposhtme:

Tregues	Vlera
Fatura fikse mujore	168,932.40 €
Muaj me pagesë të konfirmuar (Janar – Shkurt)	2 muaj
Totali i paguar (Janar – Shkurt 2026)	337,864.80 €
Muaji Mars – faturim i regjistruar (në proces të pagesës)	337,864.80 €

35. Grumbullimi i Mbeturinave të Amvisërisë, Mbeturinave të Vëllimshme, Grumbullimi i Pikave të Zeza

Tregues	Jan–Maj 2025	Jan–Maj 2026	Ndryshimi	Trend
Mbeturina amvisërie (ton)	20152.98	19120.68	-1032.30 ton	-5.12% ↓
Mbeturina të vëllimshme (ngarkesa)	283	387	+104	+36.75% ↑
Pikë të zeza – Maj 2026	–	454 ngarkesa	~242 ton	7 ditë/javë

3. Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik të saj për periudhën Janar – Qershor 2026, dhe bazuar në planifikimin e sektorëve në DKA mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar dhe realizuar aktivitete dhe projekte të ndryshme.

Në këtë raport përfshihen punët administrative, monitorimi dhe mbikqyrja e shkollave, shënimi i rekomandimeve për shkollat, shënime të përgjigjeve dhe vendimeve për transferimin e nxënësve të shkollave mesme të larta, organizimin e arsimit joformal, procedurat e ndërtimit të objekteve shkollore, anekseve, riparimeve, mirëmbajtjen e objekteve dhe ambienteve shkollore, projektet që lidhen me sigurinë në shkolla, planifikimin e buxhetit për çdo fillimvit shkollor, shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve etj.

Raporti për periudhën Janar – Qershor 2026 është përpiluar nga raportet e aktiviteteve, projekteve të realizuara dhe punë të tjera të kryera nga kjo drejtori, gjatë kësaj periudhe. Në këtë raport janë përmbledhur të dhënat e sektorit të arsimit dhe të administratës, punëtoritë e zhvilluara dhe aktivitete të tjera të cilat janë mbajtur.

3.1. Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave

Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës.

Raporti mbi të arriturat:

- Takime dhe vizita monitoruese në shkolla me qëllim të avancimit të cilësisë së arsimit në Komunën e Prizrenit.
- Trajnime me drejtorët e institucioneve shkollore në Prizren përmes moduleve nga programe të akredituara nga MASHTI.
- Takime me drejtues të shkollave, sekretarë, psikologë e anëtarë të këshillit të prindërve me qëllim t'i bëjmë shkollat tona mjedise miqësore, të përshtatshme dhe të sigurt për nxënësit dhe nxënëset, mësimdhënësit dhe mësimdhënëset dhe për të gjithë të tjerët.
- Janë hartuar raporte individuale në nivel shkolle dhe janë dhënë rekomandime konkrete me qëllim të avancimit të arsimit në nivel komune.
- Rishikimi dhe Racionalizimi i Rrjetit të klasave në shkolla në Komunën Prizrenit.

3.2. Kultura dhe Mjedisi

Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore

Raporti mbi të arriturat:

Bazuar në dokumentin “**Strategjia për sigurinë në institucionet edukativo – arsimore**” janë mbajtur aktivitete të ndryshme në shkolla për të garantuar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për nxënësit, mësuesit dhe stafin arsimor. Përmes aktiviteteve shkollat synojnë të parandalojnë rreziqet, t'i minimizojë incidentet dhe të promovojë një kulturë të mirëqenies.

Po vazhdon puna me ndërtimin e terreneve dhe Sallave të Edukatës Fizike në shkolla dhe furnizimi me pajisje edukativo – sportive. Po ashtu, po punohet edhe në rregullimin e ambienteve të jashtme të shkollave për të ofruar mjedis shkollor sa më të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore.

3.3. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Përmirësim domethënës i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë

Raporti mbi të arriturat:

- DKA-ja, në bashkëpunim me shkollat dhe OJQ-të që mirren me arsim, po punon në fuqizimin e modelit "komuniteti i të mësuarit së bashku".
- Shkollat janë furnizuar me mjete të TIK-ut nga DKA-ja dhe me mjete elementare të konkretizimit nga bashkëpunorët e arsimit.
- Po vazhdon pajisja e shkollave me laboratorë të ndryshëm të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në efektivitet të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Organizimi i mësimit plotësues dhe trajnimeve për nxënësit ndikon drejtpërdrejtë në ngritjen e cilësisë në arsim. DKA-ja, në bashkëpunim me Flutura Academy dhe OJQ-të që merren me fushën arsimore, po vazhdon mbajtjen e trajnimeve për nxënësit në fushën e IT-së dhe gjuhëve të huaja.
- Po ashtu janë mbajtur shumë aktivitete jashtkurrikulare të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në procesin e cilësisë në arsim.

3.4. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit parashkollor

Raporti mbi të arriturat:

Është përgaditur drafti i "Planit të Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjstrimit në Shkollë", ku së shpejti pritët të del draft dokumenti në dëgjim publik.

- Po vazhdon procesi i identifikimit të institucioneve parashkollore private. Janë mbajtur disa takime koordinuese me Inspektoratin e Arsimit, ku janë duke u koordinuar vizitat dhe mbledhja e të dhënave.
- Bashkë me agjencitë zhvillimore është duke vazhduar përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. DKA-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Kosova për të vazhduar me dhënien e shërbimeve profesionale psikologjike për fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu, vazhdon bashkëpunimi edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare (UNICEF, SCIK, etj.) për t'i përmirësuar shërbimet arsimore për nxënësit në nevojë.
- Është funksionalizuar institucioni i edukimit të hershëm në lagjen "Ortakoll". Po bëhen pëgatitjet për hapjen e institucionit për edukim të hershëm në lagjen Dardania dhe fshatin Korishë.
- Përmes garave dhe aktiviteteve të tjera ndërkulturore është duke u promovuar multikulturalizmi dhe diversiteti në arsimin parauniversitar.

3.5. Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore.

Raporti mbi të arriturat:

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një nga faktorët kryesorë që ndikon drejtpërdrejtë në ngritjen e cilësisë në arsim. DKA-ja në vazhdimësi ka hulumtuar kërkesat e menaxhmentit udhëheqës të institucioneve edukative e arsimore dhe të mësimdhënësve për zhvillim profesional. Prandaj, nga kërkesat e shkollave është vlerësuar se fillimisht zhvillimi profesional do të orientohet në fushat e menaxhimit, vlerësimit, mendimit kritik dhe gjithëpërfshirjes. Prandaj, më qëllim që mësimdhënësit të jenë sa më të përgaditur, DKA-ja ka lidhur bashkëpunim me OJQ të ndryshme si Caritas Kosova, KEC, Terre des hommes, SBASHK, etj., për trajnime profesionale. Trajnimet e ofruara janë nga programet e akredituara dhe valide për procesin e licencimit apo rilicencimit të mësimdhënësve.

3.6. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkollë - Fuqizimi i aktiviteteve profesionale në shkollë me mbështetje profesionale

Raporti mbi të arriturat: Fuqizimi i aktiviteteve profesionale në shkollë, përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë, ndërtimi, renovimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës shkollore si dhe furnizimi ka ndikuar dukshëm në përmirësimin e cilësisë së të nxënit.

Ndërtim i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe i mekanizmave për zbatim dhe monitorim të kurrikulës së re. Është intensifikuar shërbimi i këshillëdhënies për shkollat lidhur me zbatimin e KKK-së. Përmes drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë shkollat marrin këshilla nga DKA-ja për modalitetet e zbatimit të KKK-së, për sfidat e zbatimit dhe për zgjidhjet e mundshme të problemeve ad-hoc të zbatimit të KKK-së. Gjithashtu, shkollat vazhdimisht furnizohen me materiale pune, me udhërrëfyes dhe dokumentacion relevant për zbatimin e KKK-së.

Meqenëse është duke u shtuar përdorimi i mjeteve digjitale në funksion të mësimdhënies dhe nxënies, shkollat janë furnizuar me tabela të mençura si dhe me pajisje teknologjike me mbështetje nga partnerët e sektorit të arsimit.

Ka filluar implementimi i digjitalizimit të sistemit arsimor (platformës digjitale).

Për vitin shkollor 2025/2026 Drejtoria Komunale e Arsimit ka hapur thirrjen për 250 bursa për studentë në vlerë prej 700 euro.

Po ashtu për vitin shkollor 2025/2026 Drejtoria Komunale e Arsimit ndan bursa nga 300 euro për nxënës të shkollave të mesme për fëmijët e invalidëve të luftës dhe nxënës me nevoja të veçanta.

3.7. Të dhënat statistikore

Gjatë vitit shkollor 2025/2026 në institucionet publike të menaxhuara nga Komuna e Prizrenit kanë ndjekur mësimin 26.983 nxënës, në të gjitha shkollat publike me paralele të ndara, në të tri nivelet e arsimit (0, 1, 2 dhe 3) nga edukimi i hershëm (fëmijë të moshave 3-4 vjeç) deri në shkollat e mesme të larta (klasa e 12), janë si në tabelën e mëposhtme.

Numri i nxënësve sipas komuniteteve në Komunën e Prizrenit në vitin shkollor 2025 - 2026															Gjithsej
Etnia	Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Niveli i mesëm i lartë			
	Parash kollorë	Parafi llorë	I	II	III	IV	V	VI	VI I	VI II	IX	X	XI	XI I	
Shqiptarë	792	1507	1716	1751	17 91	1734	1 7 5 6	18 02	17 62	18 39	17 07	17 99	17 37	16 08	23301
Boshnjakë	18	76	94	109	12 0	107	1 0 9	13 1	12 3	13 7	15 0	14 5	12 2	13 2	1573
Turq	31	78	103	91	12 8	98	1 1 0	12 4	93	11 3	94	14 9	14 7	98	1457
Rom, Ashkali, Egjiptian	24	49	58	89	64	61	6 4	65	60	46	52	10	1	2	645
Tjerë...	5	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	7
GJITHSEJ	870	1710	1971	2040	21 03	2000	2 0 3 9	21 22	20 39	21 36	20 03	21 03	20 07	18 40	26.983
Gjithsej në nivelin e edukimit të hershëm			Shqip tarë	2299		Boshnj akë	9 4		Tu rq	10 9		Rom, Ashkali, Egjiptian, të tjerë		78	
Gjithsej në nivelin fillor klasa 1-5			Shqip tarë	8748		Boshnj akë	5 3 9		Tu rq	53 0		Rom, Ashkali, Egjiptian, të tjerë		33 6	
Gjithsej në nivelin e mesëm të ulët klasa 6-9			Shqip tarë	7110		Boshnj akë	5 4 1		Tu rq	42 4		Rom, Ashkali, Egjiptian, të tjerë		22 5	
Gjithsej në nivelin e mesëm të lartë klasa 10-12			Shqip tarë	5144		Boshnj akë	3 9 9		Tu rq	39 4		Rom, Ashkali, Egjiptian, të tjerë		13	

3.8. Aktivitetet

- Garat Komunale të Fizikanit të Ri 2026,
- Garat Komunale të Olimpiadës Matematike të Kosovës - OMK 2026,
- Olimpiada Informatike e Kosovës 2026,
- Gara Komunale - Olimpiada Kombëtare e Kimisë 2026,
- Gara Komunale - Olimpiada e Gjuhës Shqipe,
- Testi i Arritshmërisë – Përgatitja e organizimit të Testit të Arritshmërisë për vitin shkollor 2025/2026 i cili mbahet më 26 qershor,
- Testi i Maturës – Përgatitja e organizimit të Testit të Maturës për vitin shkollor 2025/2026, i cili mbahet më 20 qershor,
- Vizita në të gjitha Shkollat e Mesme të Larta për të kontrolluar dokumentet pedagogjike dhe administrative.

3.9. Trajnime, punëtori dhe punë në ekip

- Pjesëmarrje në punëtorinë për të drejtat e fëmijëve,
- Takim i komisionit për komunitetet Rom – Ashkali – Egjiptian, pranë Kuvendit Komunal,
- Organizimi i procesit mësimor në mësimin joformal,
- Mbikëqyrja e planeve të punës dhe procesit edukativo - arsimor; kontrollimi i funksionimit të organeve të shkollës, etj.,
- Bashkëpunimi me prindër, Ekipet e EPRBM të shkollës, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve,
- Monitorimi i shkollave për të kontrolluar plotësimin e standardeve për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të përshtatshëm të mësimdhënies dhe të nxënësve,
- Vlerësimi i brendshëm i shkollës në shkallë kurrikulare – “Monitorimi i nxënësve të shkollave të Komunës së Prizrenit,
- Kontrollimi i vlerësimit të brendshëm të shkollave,
- Monitorimi i funksionimit të mjeteve teknologjike të shkollave.

3.10. Infrastruktura në shkollat e Komunës së Prizrenit

Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punët edhe në këto 6 muajt e parë të vitit 2026 me realizimin e projekteve dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve në shkolla si dhe ka monitoruar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore. Janë realizuar aktivitetet e ndryshme si vijon:

- Kompletimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të inventarizimit të shkollave dhe DKA-së te zyrtarët në Drejtorinë e Financave,
- Vizitat e rregullta nëpër shkolla për verifikimin e pastërtisë dhe higjienës,
- Vizita të rregullta në çerdhen e fëmijëve për t'i evidentuar kërkesat lidhur me infrastrukturë dhe mallra.
- Janë mbajtur takimet konsultative me operatorët ekonomikë – punëkryesit lidhur me ndërtimin e objekteve shkollore.
- Janë mbikqyrë punimet e projekteve të cilat vazhdojnë nga vitet e kaluara.

Sa i përket Investimeve Kapitale të planifikuara për vitin 2025, ato janë në fazat si më poshtë:

1. Ndërtimi i çerdhes në Lagjen Tusus - Prizren

Deri më tani janë realizuar të gjitha punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) të bodrumit, përdhësës dhe etazhës së objektit. Po ashtu, po punohet në instalimin e rrjetit elektrik, të ngrohjes qendrore. Janë montuar dritaret në shumicën e hapësirave.

Për momentin, punimet janë duke vazhduar sipas planifikimit të buxhetit. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2028.

2. Ndërtimi i çerdhes në fshatin Zhur - Prizren

Projekt trevjeçar, i planifikuar do të filloj nga viti 2026. Projekti nuk ka filluar së implementuari për arsye të kontesteve mes komunitetit dhe një pronari të parcelës në kufi të parcelës ku do të ndërtohet çerdhja.

3. Ndërtimi i çerdhes në Lagjen Arbana - Prizren

Projekt trevjeçar, i planifikuar të filloj nga viti 2025. Projekti për momentin është në pritje të rregullimit të çështjeve pronësore juridike, e më pas të vazhdohet me hartimin e projektit zbatues dhe marrjes së lejes ndërtimore.

4. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" - Lutogllavë

Deri më tani janë realizuar punimet rreth 85%. Edhe pse nuk kanë përfunduar të gjitha punimet, objekti (me insistimin e drejtorit të shkollës) është funksionalizuar në tërësi që nga viti 2025. Për momentin punimet janë duke vazhduar kryesisht punimet e jashtme dhe në bodrum.

5. Rregullimi i ambientit të oborreve në shkollat e Prizrenit

Projekt trevjeçar, ka filluar së implementuari. Deri më tani janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat “Vëllezërit Frashëri” në Planejë – Has, “Emin Duraku” në Prizren, “Haziz Tola” në Prizren, “Pjetër Budi” në Lubizhdë të Hasit, “Dy Dëshmorët” në Serbicë, “Fadil Hisari” në Prizren, “Naim Frashëri” në Vlashnjë, është duke u punuar në shkollën “Ekrem Rexha” në Lubizhdë - Kontrata është trevjeçare dhe do të realizohet sipas planifikimit të DKA-së nëpër shkolla.

6. Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Mati Logoreci" në Prizren

Projekti 3 vjeçar, i cili ka filluar gjatë muajit qershor të vitit 2025.

Për shkak të natyrës së punimeve, ky projekt është planifikuar si projekt 3 vjeçar dhe kryesisht do të punohet gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht të viteve 2025, 2026 dhe 2027.

7. Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat: *Emin Duraku, Mati Logoreci, Lekë Dukagjini, Abdyl Frashëri, Hysen Rexhepi, Gani Saramati, Ibrahim Fehmiu, Fadil Hisari.*

Projekti i planifikuar ka filluar së implementuari nga viti 2025 dhe do të vazhdoj edhe për vitet 2026 dhe 2027.

8. Renovimi i objektit shkollor SHMU "Hysen Rexhepi"

Projekti për shkak të proceduarave të ankesave gjatë prokurimit si dhe për shkak të natyrës së punimeve, është planifikuar që të implementohet gjatë muajve korrik dhe gusht të vitit 2026.

9. Renovimi i objektit shkollor në Fshatin Gjonaj (objekti i vjetër)

Projekt 2 vjeçar, ka filluar implementimi në vitin 2025. Deri më tani janë realizuar punimet në pastrimin dhe demolimin e materialeve të ndryshme si brenda objektit, po ashtu edhe jashtë. Pastaj, është realizuar ndërrimi i kulmit në tërësi si dhe disa punime tjera të vrazhda. Varësisht nga planifikimi i buxhetit për këtë projekt, punimet parashihen të përfundojnë gjatë vitit 2027.

10. Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Zef Lush Marku" - Velezhë

Projekt trevjeçar, ka filluar nga qershori i vitit 2025, dhe sipas planifikimit të buxhetit, i njëjti pritët të përfundoj gjatë fundvitit të vitit 2027 apo në fillim të vitit 2028. Deri më tani kryesisht janë realizuar punimet e vrazhda si: themelet, shtyllat, trajet dhe pllakat për dy nivele.

11. Ndërrimi i kalldajave të ngrohjes qendrore, në shkollat: SHFMU "Motrat Qiriazhi" lagjja "Kurilla" - Prizren, "Luigj Gurakuqi" - Nashec dhe "Brigada 125" - Medvec

Projekti ka filluar nga viti 2025, ku është bërë ndërrimi i kalldajave në shkollën "Brigada 125" në Medvec dhe në shkollën "Luigj Gurakuqi" në Nashec. Për momentin punimet janë duke u ekzekutuar në shkollën "Motrat Qiriazhi".

12. Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në SHMU "Gani Saramati"

Projekt 3 vjeçar, filluar nga viti 2025. Deri më tani janë realizuar të gjitha punimet e vrazhda nëpër tri nivelet e objektit. Kanë filluar punimet në instalimin e rrjetit elektrik dhe instalimeve tjera. Po ashtu, po suvatosen muret a hapësirave të brendshme. Varësisht nga buxheti projekti pritet të përfundojë gjatë fundvitit të vitit 2027.

13. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Fatmir Berisha" - Prizren

Projekt i filluar nga viti 2025. Deri më tani janë realizuar punimet e vrazhda nëpër nivelet e objektit. Kanë filluar punimet zejtare dhe projekti pritet të përfundojë gjatë vitit 2026.

14. Ndërtimi i deposë për lëndë djegëse për ngrohje në SHFMU "Lekë Dukagjini" - Prizren dhe "Mushnikova" - Mushnikovë

Projekt i planifikuar të filloj nga viti 2025, por për shkak të ankesave të shumta gjatë procedurës së prokurimit, do të filloj së realizuari nga muaji Qershor 2026. Varësisht nga buxheti, projekti pritet të përfundojë gjatë fundvitit 2026.

15. Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Dëshmorët e Zhurit" - Zhur


Projekt trevjeçar, i cili për shkak të natyrës së punimeve si dhe nënshkrimit të vonshëm të kontratës është planifikuar të punohet gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht të viteve 2026, 2027 dhe 2028.

16. Renovimi i objektit shkollor "Mustafa Baku" - Prizren

Projekti, për shkak të natyrës së punimeve si dhe nënshkrimit të vonshëm të kontratës është planifikuar të punohet gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht të vitit 2026, por, edhe nëse do të ketë mjete financiare pasi që ky projekt nuk ka arritur që të paraqitet në buxhetin e vitit 2026 si projekt i rregullt.

Në pasqyrën e poshtëshënuar keni përqindjen e shpenzimeve për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe investimeve kapitale duke kalkuluar edhe përqindjen e ekzekutimeve përmbarimore:

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Shpenzimet	Zotimet/obligimet e papaguara	Mjete të lira	% e shpenzimeve
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	248,955.00	215,859.04	22,527.89	10,568.07	95.8
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHE-PRIZREN	405,500.00	285,394.55	66,843.94	53,261.51	86.9
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	2,944,411.78	2,224,610.69	410,918.16	308,882.93	89.5
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZREN	394,174.00	230,026.03	67,249.75	96,898.22	75.4
21 TË HYRAT VETANAKE	156,093.00	128,868.38	10,000.00	17,224.62	89.0



4. Drejtoria e Shëndetësisë

Drejtoria e Shëndetësisë, gjatë periudhës Janar – Maj 2026 ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve të punës, si nga investimet kapitale ashtu edhe në mallra dhe shërbime. Gjatë kësaj periudhe, përmes QKMF-së është ofruar një numër mjaft i madh edhe sa i përket shërbimeve shëndetësore.

Në fillim të kësaj periudhe, kemi ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për iniciimin e procedurave për realizimin e projekteve të parapara për këtë vit, si nga kategoria e investimeve kapitale, ashtu edhe nga

kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Mirëpo, për shkak të marrjes së mjeteve nga ana e përmbaruesit, shumë nga këto projekte janë pezulluar.

Nga kategoria e investimeve kapitale, kanë vazhduar punimet në projektet:

1. Ndërtimi i QKMF-së te ish kampi i KFOR-it
2. Ndërtimi i QMF-së në Lagjen Tusus

Projektet e tjera kapitale të parapara për të cilat janë inicuar procedurat për realizim, janë:

- Furnizimi me aparatura mjekësore,
- furnizimi me aparatura jo mjekësore,
- furnizimi me pajisje stomatologjike dhe
- furnizimi me pajisje laboratorike.

Në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, kemi inicuar procedurat përkatëse të prokurimit për furnizimet dhe projektet siç janë: furnizimi me reagenca, mbushja dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit, dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve të KPSH-ë, furnizimi me inventar për ordianca shëndetësore, mirëmbajtja e ashensorëve dhe gjeneratorëve në objektet e KPSH-së, sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së, furnizimi me material administrativ për zyra, mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të KPSH-së për të cilën është nënshkruar edhe kontrata, printimi i protokoleve klinike të KPSH-së, furnizimi me kuti të ankesave për nevojat e KPSH-së. Për disa nga këto projekte, janë bërë furnizimet përkatëse për plotësim të nevojave të përditshme të institucioneve shëndetësore nga kontratat aktive të cilat janë lidhur nga viti kaluar.

Sa i përket shërbimeve shëndetësore, gjatë kësaj periudhe, QKMF-ja ka ofruar një numër të madh të shërbimeve shëndetësore. Ky numër arrin shifrën e rreth **376,878** shërbime shëndetësore, duke përfshirë shërbimet: vizita specialistike mjekësore, vaksinim, analiza laboratorike, rtg, shërbime urgjente, shërbime geriatrike, shërbime të kujdesit paliativ, shërbime stomatologjike, vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë, teste rapide, EKG, fashime, inhalime, injeksione, infuzione, këshillime, udhëzime, etj.

Në këtë periudhë ka filluar dhe përfunduar realizimi i vizitave sistematike në shkollat për nxënësit e klasave 1, 5 dhe 9 në Komunën e Prizrenit.

Në kuadër të shënimit të Ditëve Botërore, me aktivitete të ndryshme përfshirë këtu ligjerata, shpërndarje të fletushkave, aktivitete në Sheshin Shadërvan, etj., kemi shënuar këto ditë:

1. Dita Botërore e Kancerit;

2. Dita Botërore e Tuberkulozit;
3. Dita Botërore e Shëndetit;
4. Java Botërore e Imunizimit;
5. Dita Botërore e Hipertensionit;
6. Dita Botërore e Duhanit;

Në këtë periudhë ka filluar edhe pranimi i dokumentacioneve për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara në rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Fluksi i personave që kanë aplikuar për mbështetje ka qenë mjaft i madh. Nga muaji shkurt kur është hapur aplikimi e deri në fund të muajit maj 2026, janë parashtruar 792 kërkesa për mbështetje financiare nga këto kategori. Prej tyre, deri më tani pagesa është realizuar për 133 kërkesa, përkatësisht për kërkesat e muajit shkurt dhe disa kërkesa që kanë qenë kthime nga kërkesat e vitit të kaluar në vlerë prej 53,200.00 euro.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është realizuar pagesa edhe për 252 persona kërkesat e të cilëve janë pranuar më 2025, mirëpo si shkak i mungesës së mjeteve financiare më 2025 janë përcjellur për realizim më 2026. Shuma që është ndarë për këta persona kap vlerën e 100,800.00 eurove.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë vizita inspektuese nëpër institucionet shëndetësore, sipas nevojës.

Në hapjen e realizimit të vizitave sistematike, është bërë vizitë nga ana e drejtorit dhe Kryetarit gjatë kryerjes së këtyre vizitave nëpër shkolla.

Gjatë kësaj periudhe janë dorëzuar të kompletuara lëndët për legalizim të objekteve të KPSH-së të cilat nuk janë të pajisura me leje ndërtimore.

Gjatë muajit maj është bërë dorëzimi i pajisjes së ergometrisë si donacion për Spitalin Rajonal në Prizren nga Komuna e Prizrenit.

5. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor

Hartimi i PZHK-së është dokument shumë me rëndësi me të cilën DUPH-ja do të punoj një kohë e gjatë ku do të përcaktohen zonimet e zhvillimit të pjesës urbane dhe rurale, me Ligjet, përkatësisht Udhëzimet Administrative që e rregullojnë sferën e planifikimit dhe pritet konfirmimi për VSM-në nga MMPHI-ja.

- Vazhdimi i procedurës për trajtimin e ndërtimeve pa leje – Legalizimi i objekteve,
- Hapja e rrugëve sipas HZK (projekt i ri),
- Rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve në objektet e banimit kolektiv,

- Është bërë përzgjedhja e objekteve ku do të bëhet rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve që tani është në fazën e ekzekutimit të punimeve.
- Sigurimi i kushteve optimale për banorët dhe përmirësimi i pamjes urbanistike të lagjeve ku janë banimet kolektive.
- Hartimi i planeve rregullative urbane sipas HZK (projekt i ri),
- Staf Konsulent (mbështetës) për Komunën e Prizrenit - Konsulent për ndërlidhjen e qytetarëve me adresa në sistemin e adresave - ARIS,
- Konsulent individual për krijimin e task forcës së përkohshme për regjistrimin - futjen e të dhënave të adresave në sistemin IS në Komunën e Prizrenit.

Numri i kërkesave	Kërkesat e pranuar	Kërkesat e vendosura									
		njoftimet	Te miratuara	Deklarata, vërtetim, akt-përcjellëse, propozime	Te refuzuara	Te hedhura poshtë	Procedura është pezulluar	Lëndët në procedurë	Ekstrat për Prevalle	Qasje në doku. zyrtar	Ankesat e dërguara në MMPH
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor	Lëndët e pranuar për periudhën 01.07.2025 - 21.11.2025	67	157	40	72	25	2	171	8	5	5

Pasqyra tabelore mbi gjendjen e vendosjes së lëndëve në sektorin e Urbanizmit

Zyra e adresave: Tabelat me emrat e rrugëve: Në këtë periudhë janë identifikuar mbi 10 rrugë me mungesë të tabelave të emrave.

Kërkesa dhe ankesa: Në këtë periudhë kemi pranuar 20 lëndë me kërkesa dhe ankesa në lidhje me emrat e rrugëve të cilat kanë kaluar te komisioni për emërtimin e rrugëve për shqyrtim.

Ndërlidhja e qytetarëve me adresat: Në këtë periudhë 6.667 qytetarë kanë përditësuar adresën e tyre.

6. Drejtoria e Inspektorateve

6.1. Inspektoriati Komunal - Punët e Inspektoriatit Komunal janë realizuar sipas planit dhe programit të paraparë për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2026.

Sipas planit kemi vepruar në pjesë të ndryshme të qytetit rreth pastërtisë së qytetit lidhur me largimin e materialeve të ndryshme ndërtimore si: rërë, blloqe, hekur, etj., nga hapësira publike (trotuare). Kemi planifikuar dhe realizuar aksione për lirimin e hapësirave publike nga vendosja e objekteve të përkohshme: tezgave dhe ekspozimin e mallrave (pemë, perime, tekstil, plastikë, etj.) nga bizneset e

ndryshme, pasi që DUPH-ja i ka refuzuar kërkesat për pajisje me leje të këtyre bizneseve. Në të njëjtin aksion nga rrugët e qytetit janë larguar rrethoja, pengesa të ndryshme, reklama lëvizëse dhe statike të vendosura pa leje të organeve kompetente komunale.

Inspektorët komunalë kanë inspektuar hapësirat publike rrugët dhe trotualet ku zhvillohen tregjet ditën e tregut në qytetin e Prizrenit. Të gjithë shitësit ambulant dhe prodhuesit e ndryshëm janë sistemuar në tregjet legale të caktuara nga organet kompetente komunale.

Kemi inspektuar bizneset që ekspozojnë tavolina, karrige si dhe lokale afariste që ekspozojnë mallra të ndryshme në hapësira publike dhe të njëjtat janë pajisur me leje në një numër të konsiderueshëm, ndërsa një numër i këtyre bizneseve janë në procedurë të pajisjes me leje nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Është asistuar Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Pronës dhe të gjitha drejtoritë komunale sa herë që është kërkuar nga ky inspektorat.

Janë inspektuar të gjitha kërkesat e palëve që i janë adresuar inspektoratit komunal, shumë prej tyre janë zgjidh ndërsa të tjerat janë në procedurë, varësisht prej problemeve të paraqitura në procedura.

Inspektoriati Komunal i Mjedisit - ka monitoruar aktvendimet për leje mjedisore të ardhura nga MMPH-ja, ka inspektuar bizneset të cilat i nënshtrohen Lejeve Mjedisore Komunale, krijimin e pikave ilegale të mbeturinave dhe punë të tjera sipas autorizimeve ligjore. Ka inspektuar një operator ekonomik në fshatin Lubizhdë e Prizrenit ku operatori ekonomik është obliguar t'i vendos filtrat në oxhaqet e fabrikës dhe i njëjti i ka vendosur filtrat dhe sipas banorëve është reduktuar ndotja e ajrit në masë të madhe, gjithashtu, ka vendosur edhe filterin tjetër kundër lirimit të aromave të këqija. Ka inspektuar operatorin ekonomik Eko-Regjioni dhe ka konstatuar se operatori po vepron sipas planit dinamik dhe kontratës me Komunën e Prizrenit. Ka inspektuar hedhjen e mbeturinave në hapësira publike.

Inspektoriati i Komunikacionit - me zyrtarët e DSHP-së, ka inspektuar kërkesat për vazhdimin e lejeve për taksi. Në kuadër të kompetencave ligjore ka bërë inspektime të rregullta, ka inspektuar respektimin e orarit nga transportuesit e transportit publik të udhëtarëve, si dhe për eliminimin e parregullsive tjera eventuale në transportin publik të udhëtarëve.

Në bashkëpunim me inspektoratin komunal dhe Policinë e Kosovës janë inspektuar të gjitha vendqëndrimet për taksi në Komunën e Prizrenit dhe punë të tjera sipas autorizimeve ligjore.

Nr.	Muaji	Proces-verbale	Akt-vendime	kërkesa për kundërvajtje	Ekzekutime	Urdhër ekzekutimi	Konkluzi one/kon. shp.	D. mandatore	Njomftime raporte	Kall pen	Asgj. i
1.	Janar	66	5				/	/	/		
2.	Shkurt	65	7	/		1	/	1x100=100€	2		
3.	Mars	99	52		/		/		/		
4.	Prill	106	45	/		2	/	€	1		1
5.	Maj	73	23	/	/	/	/	3=400€			1
6.	Qershor	18	1	1	/	/	/	1=100€	/		
Gjithsej:		409	132	1		3		5=600€	3	/	2

6.2. Inspektoriati i Tregut

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, Sektori i Tregut ka zhvilluar aktivitetet e tij në përputhje me mundësitë operative, duke pasur parasysh se institucioni ka qenë në periudhë tranzicioni prej datës 06.02.2026 dhe se kompetencat e inspektimit të tregut janë të pezulluara për një periudhë të pacaktuar. Pavarësisht këtyre rrethanave, sektori ka trajtuar një numër rastesh, ankesash dhe kërkesash të qytetarëve dhe institucioneve si dhe ka realizuar aktivitete këshilluese dhe mbikëqyrëse në terren.

Kontrolla me procesverbal: 90

Aktvendime: 23

Pëlqim min-teknik: 30

Kërkesë për kundërvajtje: 13

Plotësim kërkesë: /

Kërkesë shkallës II-të: /

Ndalimi i veprimtarisë: /

Mall i asgjësuar: 31.884€

Reklamacione: 17

Gjopa: /

Refuzime: 7600€

6.3. Inspektoriati i Ndërtimit

Ky sektor në bazë të detyrave programore, kryesisht është marrë me përpunimin e lëndëve me problematikë të ndërtimit si: mbikëqyrjen e projekteve, mbikëqyrjen e objekteve, formimin komisioneve profesionale, kontrollimin e projekteve për fazat, hapjen dhe vlerësimin e tenderëve, marrja pjesë në komisionet për hartimin e rregulloreve të ndryshme të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtori i drejtorisë për lëminë e ndërtimit dhe veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor.

Kontrollimi i terrenit - është bërë mbulimi i terrenit dhe kontrollimi i vazhdueshëm përkundër faktit se kemi mungesë të inspektorëve, gjegjësisht si e arritur mund të veçohet bashkëpunimi dhe puna ekipore brenda Sektorit të Ndërtimit, ku janë arritur rezultate si vijon:

Kontrollimi sistematik i objekteve me leje si: objekte afariste, banim kolektiv, shtëpi banimi, depo, objekte të karakterit të përkohshëm, kiosqe, etj.

Ndërprerja e ndërtimeve pa leje si: objekte afariste, banim kolektiv, shtëpi banimi, depo, objekte të karakterit të përkohshëm, kiosqe, etj.

Rrënimi i objekteve: është bërë rrënimi i punimeve të ndërtuara pa leje ndërtimore e objektit bujqësor në rrugën “Tranziti i Vjetër”, pjesa ku ka tejkallim të lejes ndërtimore. Rrënimi është kryer nga operatori ekonomik dhe vetë investitori.

- Është bërë rrënimi i punimeve ndërtimore të pjesa ku ka tejkallim të lejes ndërtimore për objektin bujqësor në rrugën “Tranziti i vjetër”. Rrënimi është kryer në mënyrë vullnetare nga vet investori pas pranimit të aktvendimit për rrënim vullnetar.
- Është duke vazhduar rrënimi i punimeve ndërtimore të kryera pa leje ndërtimore në pjesën ku ka tejkallim të lejes, të objekti afarist i cili ndodhet në rrugën “Jusuf Gërvalla”. Ekzekutimi është duke u kryer nga OE-ja.
- Rrënimi i objektit-aneks të objektit ekzistues në lagjen “Lakuriqi Verior 2”, të ndërtuar pa leje ndërtimore. Objekti është rrënuar nga OE-ja.
- Demolimi/rrënimi i objektit-depo në rrugën Prizren-Korishë, i ndërtuar pa leje ndërtimore nga organi kompetent. Objekti është rrënuar nga vet investori pas pranimit të aktvendimit për rrënim vullnetar.
- Rrënimi i objektit-depo në rrugën “Tranziti i Vjetër” i ndërtuar pa leje ndërtimore nga organi kompetent. Rrënimi është kryer nga OE-ja dhe vet investori.
- Rrënimi i punimeve të ndërtuara pa leje ndërtimore në rrugën “Ersan Mazreku” nga konstruksioni metalik. Rrënimi është kryer nga vet investori pas pranimit të aktvendimit për rrënim vullnetar.

- Rrënimi ka filluar në rrugën “Zahir Pajaziti” në mbindërtimin e objektit ekzistues pa leje ndërtimore, mirëpo për shkak të masës së përkohshme të lëshuar nga gjykata është ndërprerë ekzekutimi (rrënimi).
- Rrënimi në rrugën “Rifat Ukimeri” në Ortakoll – Tejkalim i lejes ndërtimore të objekti shtëpi banimi me lokale afariste - ka filluar rrënimi dhe më pas investitori ka prezentuar gjatë rrënimit aktvendimin për masën e sigurisë nga Gjykata Themelore - rrënimi pritet të vazhdojë ditët në vijim, sapo të kemi mundësi të lirë për rrënimë, etj.

Procedurat e zhvilluara gjatë mbikëqyrjes inspektive:

Procesverbale: 365

Aktvendime: 65

Ekzekutime: 11

Urdhër Ekzekutime: 11

Kallxime penale: 19

Aktvendime për gjoba mandatore: 18

Gjoba Mandatore: 34

Kërkesa për përmbarrim të gjobave mandatore, Avokatura Publike e Komunës së Prizrenit: 0

Gjoba mandatore në vlerë të përgjithshme: 17.000 euro

Gjobat mandatore të paguara gjatë muajve Janar - Qershor: 8.000 euro

7. Drejtoria e Administratës

Shërbimi i Administratës së Përgjithshme, përfshin në vetë shërbime të shumta dhe të ndryshme, të cilat kryhen për nevoja të qytetarëve, si për brenda Republikës së Kosovës, ashtu edhe jashtë saj.

Më poshtë keni edhe shifrat e sakta të këtyre shërbimeve, të cilat janë proceduar dhe përfunduar gjatë kësaj periudhe, deri më 15.06.2026:

Varshmëri për mbajtje materiale: vlen për shërbimet jashtë vendit, gjithsej 97 lëndë të proceduara dhe të përfunduara,

Dokument i gjendjes familjare për lejimin e shtesave: kryesisht vlen për shërbimet jashtë vendit, gjithsej 25 lëndë.

Certifikatë e dëshmisë (që është i njejtë person, që personi është i ve, që është banor i përkohshëm, që është në raport farefisnor, etj): kryesisht lëshohen për konstatim të fakteve brenda dhe jashtë vendit, rregullim

dokumentacioni për pronat dhe gabimet teknike të paraqitura në to, gjithsej **210** lëndë të proceduara dhe të përfunduara.

Deklaratë për ushqimin për vitin e kaluar kalendarik: zakonisht ky dokument lëshohet gjithmonë për vitin e kaluar kalendarik dhe dëshmon mbajtjen materiale të një familjari ndaj tjetrit, vlen për botën e jashtme, gjithsej **960** lëndë të proceduara dhe të përfunduara.

Përveç këtyre shërbimeve me pagesë, gjatë kësaj periudhe të vitit kemi kryer edhe shërbime të shumta të cilat janë pa pagesë dhe në formën e ndihmës juridike, përpilim të kërkesave dhe shkresave të ndryshme.

Spektori merret me mirëmbajtjen, riparimin, furnizimin, sigurimin, pastrimin dhe mbarvajtjen e punës së Komunes në tërësi si dhe objekteve tjera dhe makinave.

Lendët për shqyrtim nga Drejtori i Administratës për periudhën Janar-Qershor 2026

Departamenti	në Proces	Miratuar	Refuzuar	Ceduar	Totali
Administrata	94	16	13	1	124

7.1.Spektori për Mbështetje dhe Logjistikë

Objektet e Komunes që janë në renovim:

1. Renovimi i zyrës së vendit në Tusus,
2. Renovimi i zyreve të nënkryetarit të Komunes për Komunitete,
3. Ndërrimi i dritave të Asamblesë Komunale,
4. Rregullimi banjove në Shtëpinë e Bardhe, Inspektorat dhe Administratë,
5. Ngjyrosja e Drejtorisë së Financave,
6. Ngjyrosja e koridoreve të Administratës,
7. Në përfundim të renovimit të tërësishëm të Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
8. Sinjalizimi dhe vendosja e rampave te parkingu tek objekti i Administratës,
9. Përfundimi dhe përrurimi i Memorialit të Martireve në Krushë të Vogël,
10. Mbështetja e organizimit të Epopesë së Gorozhupit,
11. Mbështetja dhe organizimi i festave, përvjetorëve si vendosja e flamujve në lapidare dhe qytet.

7.2. Arkiva dhe shërbimet juridike

Raporti përmban të dhëna mbi aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe, menaxhimin e dokumentacionit arkivor, pranimin dhe sistemimin e lëndëve si dhe çështje të tjera relevante që lidhen me funksionimin e arkivit komunal. Gjatë periudhës gjashtëmujore, aktivitetet e Arkivit Komunal janë

fokusuar kryesisht në trajtimin e kërkesave për dokumentacion nga sektori i Gjendjes Civile - mbi 250 kërkesa.

Në kuadër të bashkëpunimit me Gjendjen Civile, është ofruar qasje dhe mbështetje për gjetjen, verifikimin dhe sigurimin e dokumentacionit arkivor të nevojshëm për qytetarët dhe institucionet. Gjatë kësaj periudhe është shënuar një numër i konsiderueshëm kërkesash, të cilat janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe sipas procedurave në fuqi.

Një pjesë e rëndësishme e punës ka qenë arkivimi elektronik i dokumenteve numri i të cilave kalon mbi 10.000. Përveç kërkesave nga Gjendja Civile, janë trajtuar edhe kërkesa nga Urbanizmi për qasje në dokumentacion arkivor ku numri është 77 që lidhet me lëndët dhe dokumentet e periudhave të mëparshme. Edhe pse në numër më të vogël, këto kërkesa kanë kërkuar shqyrtim dhe verifikim të dokumentacionit përkatës.

7.3. Sektori i Teknologjisë Informative

Zyra e TI-së vepron si pikë kryesore e Komunës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë informative, të qeverisjes elektronike dhe të proceseve administrative në Komunë. Merret me mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike si kompjuterë, monitorë. Përveç kësaj bën mirëmbajtjen e rrjetit lokal – LAN dhe ËAN, rrjetit në mes ndërtesës kryesore dhe ndërtesave tjera të Kuvendit (Presidenca, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Emergjencia dhe Zjarrfikësit, ish-Kadastrë, Biblioteka), jep mbështetje për funksionimin e mirëfilltë të rrjetave të Zyrave të Gjendjes Civile, jep mbështetje si administrator lokal për aplikacionet e ndryshme qeveritare si Intraneti, E-pasuria, E-depoja, E-arkiva, Gjendja Civile dhe bën hapjen e e-mailit zyrtar, etj.

Pastaj, bën formatizimin dhe instalimin e programeve të licencuara nëpër kompjuter, bën administrimin lokal në ueb faqen e Komunës. Të gjithë kompjuterët e Kuvendit të Prizrenit janë futur në domenin qeveritar dhe i shfrytëzojnë aplikacionet e licencuara të Windows-it, Office-it dhe antivirusit (Sofos).

Viti 2026		
Nr	Veprimi i ndërmarrë	Janar - Qershor 2026
1	Formatizimi dhe instalimi i aplikacioneve në kompjuterët ekzistues.	60 formatizime

2	Mirëmbajtja e dhomës së serverit në ndërtesën e Komunës dhe ndërlidhja e tyre me ndërtesat: Statistika, Financa, Beledije, Presidenca, QPS, Brigada e Zjarrfikësve, Biblioteka e qytetit, DKA, Shtëpia e të Moshuarve, Shtëpia Rezidenciale, etj.	30 intervenim
3	Vërja në funksion të zërimit dhe mbledhjeve të Kuvendit dhe takimeve.	10 incizime
4	Vërja në funksion të zërimit për mbledhjet e ndryshme, p.sh. Debate publike, mbledhjet e OJQ-ve, KKSBB dhe ZKK, etj.	10 zërime
5	Intervenime të ndryshme nëpër zyrat e gjendjes civile: Gjonaj, Romajë, Piranë, Zhur, Hoçë të Qytetit, Korishë, Velezhë, Lubizhdë, Reçan, Lubinjë e poshtme, Mushnikovë.	40 Intervenime
6	Instalimi i Kompjuterëve dhe pajisje të tjera përcjellëse (skaner) dhe konfigurimi i sistemit operativ dhe aplikacioneve në kompjuterët e rinj si dhe futja e tyre në domenin qeveritar.	50 instalime
7	Instalimi i printerëve të rinj me kontratë.	50 instalime
8	Mbështetje teknike zyrtarëve të Ministrisë së Punës – Inspektorati i punës për shkak të mungesës së IT-së.	15 Mbështetje

7.4. Sektori i Gjendjes Civile

Sektori i Gjendjes Civile në Prizren (ZGJC OSSH - GJC Zyrat e Vendit), gjatë kësaj periudhe ka dhënë këto shërbime:

Sektori i Gjendjes Civile - Prizren	Gjithsej
Ekstrakt të lindjes	29233
Certifikata të lindjes	13713
Certifika të martesës	6504
Certifikata të vdekjes	3072
Certifikata të statusit martesor	1623
Certifikata të vendbanimit	4362
Certifikata të shtetësisë	1145
Certifikata të vërtetimit nga arkivi	1027
Deklarata të Bashkësisë Familjare	1586
TOTALI I CERTIFIKATAVE:	62265
Adresat e vendbanimit të Regjistruara në ZGJC	21,275
Adresat e vendbanimit të Regjistruara në e-Kosova	5,943
TOTALI I ADRESAVE TË VENDBANIMIT TË REGJISTRUARA	27,218
Akt Vdekjeje - Dëshmi vdekjeje	476
Kërkesë për Lirim nga Shtetësia, kërkesa për Fitim të Shtetësisë - Rikthim i shtetësisë	210
Vendime për korigjime, ndërrime dhe regjistrime suplementare	188
LINDJE:	1287
Të Rregullta;	1188
Brenda vendit	990
Jashtë vendit	198
Me vonesë;	99

Brenda vendit	3
jashtë vendit	96
Verifikime	125
me nr. personal paraprak	116
me gjenerim të nr. personal	9
RISHKRIM LINDJE;	122
REGJISTRIM I QYTETARIT	26
Sipas nenit 31	5
Me vendim të Komisionit për Shtetësi	21
MARTESA:	526
E rregullt	451
Jashtë vendit	75
RISHKRIM MARTESE:	389
Brenda vendit	375
Jashtë vendit	14
SHKURORËZIME;	54
MARTESË ME ELEMENT TË HUAJ	120
1. Bashkëshorti shtetas i huaj	54
2. Bashkëshortja shtetase e huaj	66

7.5. Sektori i Shërbimeve me Qytetarë

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, Sektori i Shërbimeve me Qytetarë ka pranuar dhe proceduar gjithsej **6,636 lëndë**.

Lëndët e trajtuara gjatë kësaj periudhe kanë të bëjnë me: kërkesa, ankesa, caktim të termineve, korrigjime, pëlqime, aplikime të ndryshme, protokolim të faturave, subvencione shëndetësore si dhe çështje të tjera administrative.

Gjatë kësaj periudhe, sektori ka ofruar shërbime të vazhdueshme dhe ka siguruar trajtimin efikas të të gjitha lëndëve të pranura.

7.6. Zyra ekspeditive KK Prizren

Lëndë të shpërndara nëpër drejtori - 860

Lëndë të dërguara jashtë institucionit - 780

Lëndë të shpërndara nëpër fshatra - 306

Lëndë për Kryetarin e Komunës - 305

Lëndë të dorëzuara në gjykatë - 484


Lëndë për gjykatë nga GJC - 30

Lëndë pranim-dorëzim në postë – 2158

8. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit


Gjatë kësaj periudhe si drejtori kemi pranuar **9712** kërkesa në kuadër të sektorit të gjeodezisë dhe kadastrit: si kontratat e shitblerjes, kontratat e dhurimit, aktgjykimet, aktvendimet, lista poseduese, kopje te planit, ndarjet e parcelave, bashkimet e parcelave, regjistrimet e objekteve dhe pjesëve të objekteve. Nga këto lloje të lëndëve si numër:

- 9293 kërkesa janë miratuar,
- 243 janë ne proces e sipër,
- 77 kërkesa janë refuzuar
- 16 janë pezulluar
- 82 janë anuluar për shkaqe të gabimeve teknike.¹



Në bazë të të dhënave të lartshënuara me përqindje 95.7 të kërkesave janë miratuar, 2.5 përqind janë në proces. Ndërsa 0.2 janë të refuzuara.

¹ Këto të dhëna janë marrë nga sistemi zyrtar Intranet dhe paraqesin pasqyrën e lëndëve deri më datën 16.06.2025



Në këtë periudhë nga shërbimet të lartë përmendura janë grumbulluar si te hyra komunale prej 115,74² euro. Aktivitetet më të rëndësishme që janë marrë në këtë periudhë janë:

Perpilimi i dokumentacionit: Pasi që Komuna e Prizrenit është përfituese e projektit “Prizren Public Building Energy Efficiency Programme: Reconstruction, rehabilitation or refurbishment of set of public building to improve energy efficiency” që parashihet renovimi i gjithsej 43 objekteve publike, të cilat përfshijnë institucione arsimore dhe shëndetësore në Komunën tonë. Është përpiluar dokumentacioni (incizimet, evidentimet, pëlqimet) për t’u pajisur me leje të renovimit.

Piketimet: Gjatë afatit të raportues sipas kërkesave të Drejtorive janë kryer piketimet e rrugëve, objekteve komunale dhe hapësirave publike.

Matjet Gjeodezike: Janë bërë matjet në teren sipas kërkesave të drejtorive për incizimet e gjendjeve faktike dhe projektet të cilat janë kërkuar nga drejtoritë përkatëse.

9. Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ky raport pasqyron aktivitetet, angazhimet dhe rezultatet e punës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, duke përfshirë të gjitha fushat dhe çështjet që ndërlidhen me mirëqenien sociale në Komunën e Prizrenit. Në të paraqiten në mënyrë të përmbledhur aktivitetet dhe veprimtaritë e realizuara nga Drejtoria, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet nën përgjegjësinë e saj,

² Këto të dhëna janë të datës 12.06.2026 të dërguara nga Drejtoria e Financave.

përfshirë Qendrën për Punë Sociale, Qendrën Rezidenciale dhe Shtëpinë për të Moshuar. Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria ka vazhduar angazhimin në ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale, përballimin e nevojave të qytetarëve në gjendje sociale të cënueshme si dhe koordinimin e punës me institucionet relevante me qëllim të avancimit të mirëqenies sociale në Komunë.

Disa nga projektet kryesore:

Projekti: Ndërtimi i banesave sociale ne Lagjen Petrovë Kulla 4 (Vazhdim i projektit) - po vazhdojnë punimet për përfundimin e këtij objekti, punët e të cilit janë ndërprerë vite më parë. Vlera e paraparë e këtij projekti është 492,000.00 Euro, të realizuara 346.648,00 Euro - projekti pritët të përfundojë në muajin Gusht 2026.

Renovimi i banesave kolektive në Lagjen Petrovë Kulla 3 - kanë përfunduar të gjitha punimet, janë në prag të funksionalizimit, sapo të zgjidhen çështjet me KEDS-in lidhur me furnizimin me energji elektrike.

Ndërtimi i kulmeve për familjet skamnore - në procedurë të rregullimit ku gjithsej janë 74, kanë përfunduar 53 kulme, në proces janë dhe 20. Vlera e kontratës 624,724,00 euro, të paguara 267,928.00 euro.

Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve - janë duke vazhduar punimet. Vlera e parashikuar e projektit është: 615,451.16 Euro. Janë realizuar 255,000.00 Euro.

Ndërtimi i Qendrës Rekreative Sportive - po vazhdojnë punimet. Vlera e investimit është 168,242,72 Euro. Të realizuara 132.018,95 Euro.

Projektet tjera:

Furnizim me veshmbathje për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me probleme të shëndetit mendor dhe shtëpisë së të moshuarve. Ky projekt është në fazën e tenderimit nga Zyra e Prokurimit.

Furnizim me medikamente dhe material shpenzues për banorët e Shtëpisë Rezidenciale dhe Shtëpise së Pleqve. Ky projekt është në fazën e tenderimit nga Zyra e Prokurimit.

Hartimi i projekteve të ndryshme për DPMS. Është lidhur kontrata gjatë vitit të kaluar. Vlera e paraparë e projektit është 100,000.00 Euro projekt kornizë, të realizuara 87,835.00 Euro.

Shërbime transporti për bartjen e fëmijëve dhe familjarëve të tyre me vështirësi sociale. Vlera e projektit është 14,993.70 euro, të realizuara 8,800.69 euro.

Mbikëqyrje e punimeve të projekteve të DPMS-së – është kontratë e cila rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave për mbikëqyrjen e projekteve të DPMS-së. Projekt dy vjeçar i cili vijon, vlera e kontratës 15,000.00 euro, të realizuara 6,220.18 Euro.

Furnizim me produkte higjienike për shtëpinë rezidenciale – është kontratë e cila rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave për banorët e shtëpisë rezidenciale ka përfunduar si projekt - vlera e projektit 11,086.60 Euro.

Subvencionet:

Mbulimi i shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit – ku është arritur marrëveshja me Ndërmarrjen Publike “Ekoregjioni” dhe bashkësitë fetare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit dhe mirëmbajtjen e hapësirave. Edhe më tutje vazhdojnë pagesat sipas faturave mujore bazuar në rastet e vdekjeve në Komunën e Prizrenit. Për 6 mujorin e parë të vitit 2026 janë paguar 158,630.00 Euro.

Subvencionimi i realizimit të projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e shërbimeve sociale: DPMS-ja ka mbështetur 21 OJQ në vlerën totale prej 100,000.00 Eurove për vitin 2025, ku shumica e OJQ-ve janë paguar gjatë vitit 2026 dhe janë në pritje edhe 8 OJQ për pagesë.

Subvencionimi i familjeve strehuese - Këtu kemi paraparë pagesën e familjeve strehuese që strehojnë fëmijë të braktisur të komunës sonë. Vlera e pagesës është 5,250.00 Euro, për këtë kategori është paraparë 25.000.00 euro për vitin 2026.

Subvencionimi i familjeve në vështirësi ekonomike me pagesë të qirasë – 14 familje janë paguar për qira 19,815.00 Euro.

9.1. Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale (QPS) është institucion publik dhe profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, brenda territorit administrativ të komunës. Në cilësinë e personit juridik, Qendra për Punë Sociale vepron në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare të përkujdesjes sociale, këshillim dhe ndihmën materiale për qytetarë në nevojë sociale. Më poshtë gjeni në tabelë shërbimet e QPS-së:

	Përshkrimi i punëve	Numri i rasteve	Shërbimet
1	Fëmijë me nevoja të veçanta	43	Evidentimi i dokumentacionit, vlerësimi i komisionit mjekësor, sesione këshilluese individuale, familjarë, marrja e vendimeve
2	Regjistrimi i mëvonshëm i fëmijëve	5	Evidentimi i dokumentacionit, verifikimi, regjistrimi, referimi në institucione të tjera

3	Fëmijët e abuzuar/ keqtrajtuar	1	Sesione këshilluese individuale, familjare, mbikëqyrje e shtuar e rasteve, strehim kur ka nevojë, vizita familjare
4	Fëmijët me sjelljes asociale	45	Sesione këshilluese individuale, familjare, mbikëqyrje e shtuar e rasteve, strehim kur ka nevojë, vizita familjare
5	Të mitur nga prokuroria	37	Intervista, këshillim psiko-social, pjesëmarrje në seanca, përpilim raporti kur është e nevojshme
6	Fëmijët me kundërvajtje	5	Intervista, këshillim psiko-social, pjesëmarrje në seanca, përpilim raporti për gjykatë.
7	Fëmijët me punë të rendë / të trafikuar	70	Zbatimi i planit operativ në bashkëpunim me policinë, intervista individuale, familjare, referim e institucione tjera
8	Fëmijët, asistim në Polici, Prokurori, Gjykatë	75	Asistim në polici, sesione këshilluese individuale, familjare, rrëfim në institucione tjera
10	Urdhërbrojtje	12	Pjesëmarrje në seanca gjyqësore, Intervista, këshillim psiko-social, pjesëmarrje në seanca, përpilim raporti për gjykatë.
12	Rastet e dhunës në familje	59	Sesione këshilluese individuale, familjare, strehim, këshillim psiko social, pjesëmarrje në seanca gjyqësore, Intervista, këshillim psiko-social, pjesëmarrje në seanca, përpilim raporti për gjykatë.
13	Kërkesë për kujdestari të fëmijës me pagës	27	Evidentimi i dokumentacionit, verifikimi, regjistrimi, sesione këshilluese individuale, familjare, caktimi i kujdestarit ligjor
14	Kërkesë për strehim të fëmijës në familje strehuese	9	Evidentimi i dokumentacionit, verifikimi, regjistrimi, sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren
15	Tentim vetëvrasje	1	sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren, bashkëpunimi me Qendrën e shëndetit mendor.
16	Procedurat e shkurorëzimit	21	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren, realizim i kontaktimeve prind-fëmijë, ndërmjetësim, raport për gjykatë
17	Procedurat e besimit të fëmijëve	10	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren realizim i kontaktimeve prind-fëmijë, ndërmjetësim, raport për gjykatë
18	Kërkesë për strehim rezidencial	2	Mbajtja e panelit, intervista me familjarët, kompletimi i dokumentacionit, vlerësimi i rrethanave, procesverbale, pëlqim vendime, marrëveshje mirëkuptimi, vizita në teren .
19	Mosmarrëveshje familjare	5	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren realizim i kontaktimeve prind-fëmijë, ndërmjetësim.
20	Kërkesë për bashkim e fëmijës me familjen	13	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren, anamneza sociale
21	Kërkesë për heqje të së drejtës prindërore	2	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren, pjesëmarrje në seanca gjyqësore .
22	Kërkesë për ri vlerësim të familjes strehuese	4	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren, raport për vazhdimin e të qenit familje strehuese
24	Njoftim, alkoolistët, narkomanët,	2	sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren, bashkëpunimi me Qendrën e shëndetit mendor.
25	Caktimi i kujdestarit për raste të veçanta	3	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren, realizim i kontaktimeve prind-fëmijë caktimi i kujdestarit të përkohshëm, raport për gjykatë
26	Konsultime referim të rasteve	40	Sesione këshilluese individuale, familjare, vizita në teren sipas nevojës, referim në institucione tjera.
27	Kërkesë për strehim në Shtëpi të Pleqve	1	Mbajtja panelit, intervista me familjarët, kompletimi i dokumentacionit, vlerësimi i rrethanave, procesverbale, pëlqim vendime, marrëveshje mirëkuptimi, vizita në teren
29	Aktivendime të Gjykatës	7	Përcjellja permanente e aktivendimeve të gjykatës
30	Martesa para moshës madhore	2	Intervista, këshillim psiko-social, pjesëmarrje në seanca, përpilim raporti për gjykatë.
31	Bashkim familjar	3	Intervista, deklarata, vizita në familje, anamnezë sociale
32	Kërkesë për dhënie e pëlqimit për pasaporta	36	Intervista, deklarata, vizita në familje, vërtetime
33	Kërkesë-Leje për trashëgimi, bartje prone, shitje, tërheqje e mjeteve	12	Intervista, deklarata, vizita në familje, bashkëpunim me institucione tjera vërtetime
34	Vërtetim për rikthim të shtetësisë	55	Kompletimi i dokumentacionit, referim për plotësim të dokumenteve, intervista, vërtetim.
35	Vërtetim për leje të armës	220	Kompletimi i dokumentacionit, referim për plotësim të dokumenteve, intervista, vërtetim
36	Vërtetim për punësim	30	Kompletimi i dokumentacionit, referim për plotësim të dokumenteve, intervista, vërtetim
36	Klient tjerë për shërbime	500	Intervista, konsultime, referim, këshillim psiko-social, vizita me institucione tjera, bashkëpunim, etj.

Skema e asistencës sociale - Skema e asistencës sociale pranë QPS-së në Prizren gjatë periudhës kohore Janar - Maj të vitit 2026 ka punuar në identifikimin e rasteve sociale, vlerësimin dhe monitorimin e tyre, gjithnjë duke u bazuar në ligjin e asistencës sociale 2003/15 dhe plotësim ndryshimin e Ligjit 04L-096 për Skemën e ndihmës sociale e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Po paraqesim skemën tabelare të familjeve dhe anëtarëve të familjeve të cilët gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale si dhe shumën e mjeteve të cilat jepen nga MFPT-i.

Muaji	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve	Shuma e mjeteve në total €
Janar	573	1966	79.200,00
Shkurt	557	1907	76.872,00
Mars	551	1895	76.656,00
Prill	529	1823	73.224,00
Maj	503	1703	69.012,00
Gjithsej:	Varion nga 573 në muajin Janar 2026, deri në 503 familje në muajin Maj 2026	Varion nga 1966 deri 1703 anëtarë	374.964.00

Numri i familjeve të verifikuara – riverifikuara gjatë periudhës Janar – Qershor 2026 janë si më poshtë:

AKTIVITETET	KATEGORIA I	KATEGORIA II	TOTALI
Numri i familjeve të verifikuara –	228	61	289

10. Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik

Projektet e kryera dhe në vazhdimësi në DTZHE janë:

1. Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambientit) turizmit kulturor – Leskovec – është kryer në tërësi ekzekutimi i projektit;
2. Ndërtimi i infrastrukturës - rrugët dhe ambienti i turizmit malor dhe rural në Nashec, Jabllanicë, Vërmicë (Projekt 2 vjeçar);
Nashec – projekti është në përfundim e sipër;
3. Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, ujë, kanalizim) Kisha e Shën Pjetrit Kabash – Korishë dhe Guri i Kallugjerit Jeshkovë – Billushë

-Kisha e Shën Pjetrit, janë kryer pagesat, jemi në procedurë të shkëputjes së kontratës me marrëveshje;

-Gurri i Kallugjerit Jeshkovë – Billushë, jemi në procedurë të ekzekutimit të pagesës së fundit.

4. Ndërtimi i infrastrukturës rrugë, ujë, kanalizim në dy burimet e ujit në fshatin Vërmicë – do të bëhet shkëputja e kontratës për shkak se operatori ekonomik është i papërgjegjshëm;
5. Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambientit – turizmi malor dhe rural) Vlashnje, Muradem – punimet janë duke vazhduar sipas afatit kohor të kontratës.
6. Ka përfunduar në tërësi projekti “Organizimi i trajnimeve për ruatjen e zejes së filigranit” dhe pritet certifikimi i kandidatëve.
7. Kurset Komek janë duke u mbajtur dhe së shpejti do të bëhet certifikimi i pjesëmarrësve.
8. Në bashkëpunim me organizatën joqeveritare Enduro është mbajtur për herë parë Festivali i Motoçiklistëve.
9. Organizimi për herë të parë i festivalit të Kampingut që u mbajt nga data 19 – 21 Qershor.
10. Kemi qenë pjesëmarrës në Panairin e Turizmit në Shqipëri “Tourism Fair Albania (TFA26) si dhe Panairin për Ditën e Besëlidhjes së Lezhës – 1 & 2 Mars 2026.
11. Është mbajtur takim për projektin “Accelerating Financial Inclusion for Tourism MSME’s in Kosovo & the Western Balkans”, një iniciativë që synon të fuqizojë kapacitetet financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme në sektorin e turizmit në Kosovë.
12. Është realizuar një takim me gazetarë nga Italia, për promovimin e turizmit të Prizrenit në kanale Italiane.
13. Është bërë aplikimi në thirrjen nga Bashkimi Evropian për EUROPEAN CAPITAL OF TOURISM.
14. Jemi në procedurë hulumtuese për vendosjen e taksave për njësitë akomoduese për turistët të huaj.
15. Janë mbajtur takimet me organizatën Guideks rreth ndalimit të operimit të ciceronëve të huaj që ushtrojnë veprimtari ilegale në Komunën e Prizrenit.

11. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë periudhës raportuese, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në realizimin e objektivave të përcaktuara me Planin e Punës 2026, Planet dhe Programet tjera zhvillimore, ligjeve, vendimeve, akteve tjera normative si dhe kërkesave të ndryshme të fermerëve dhe grupeve tjera. Projektet në realizim:

-Kapitale:

Nr	Emërtimi i projektit	Shuma e planifikuar janar-dhjetor 2026 €	Shuma e realizuar janar-qershor 2026€
1.	Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe pastrimi i kanaleve kulluese	160,000.00	20.000.00
2.	Ndërtimi i strehimores për trajtimin e qenve endacak	27,478.50	27,478.50
3.	Rehabilitimi i rrugëve fushore	193,333.33	68,667.70
	Totali:	380,811.50	116,146.20

-Subvencione me bashkëfinancim:

Nr	Emërtimi i projektit	Shuma e planifikuar janar dhjetor 2026/€	Shuma e realizuar janar qershor 2026/€
1.	Ngritja e pemishteve me pemë të imta – dredhëza dhe Boronicë	78,944.80	00
2.	Ngritja e pemishteve me pemë arvore	79,000.00	49,514.00
3.	Ndërtimi i stallave për lopë qumshore	55,342.00	55,342.00
4.	Hapja e puseve	179,460.50	109,443.39
	Totali:	392,747.30	214,299.39

-Shërbime:

Nr	Emërtimi i projektit	Shuma panifikuar janar-dhjetor 2026/€	Shuma e realizuar janar-qershor 2026/€
1.	Trajtimi i qenve endacakë	72,400.00	34,252.00
2.	Insemenimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve	103,300.00	82,192.20
	Totali:	175,700.00	116,444.20

Disa projekte nga kategoria e mallrave e shërbimeve dhe subvencione edhe pse kanë qenë të planifikuara të realizohen në vitin 2026 nuk kanë filluar procedurat për shkak se përmbaruesit i kanë marrë mjetet

Projektet në realizim janar-dhjetor 2026-----948,258.80€

Pagesat e realizuara janar-qershor 2026----- 446,817.79€

Buxheti i realizuar gjatë kësaj periudhe ka qenë 42,36%

12. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka zhvilluar një sërë aktiviteteve dhe iniciativash me fokus në fuqizimin e jetës kulturore, mbështetjen e rinisë, zhvillimin e sportit dhe promovimin e identitetit kulturor të Prizrenit.

Në fillim të mandatit të ri drejtues janë ndërmarrë veprime për organizimin dhe funksionalizimin e sektorëve të drejtorisë, përmes koordinimit me stafin, institucioneve kulturore dhe sportive si dhe planifikimit të aktiviteteve vjetore. Paralelisht është realizuar monitorimi i projekteve në zhvillim, përcjellja e investimeve në terren dhe koordinimi me operatorët ekonomikë për përmbushjen e obligimeve kontraktuale.

Në fushën e kulturës janë organizuar dhe mbështetur dhjetëra aktivitete artistike, përfshirë programi festiv për Ditën e Pavarësisë së Kosovës, promovime librash, ekspozita, koncerte, aktivitete teatrale si dhe festivale tradicionale e bashkëkohore. Veçanërisht janë shënuar me sukses festivali “Hasi Jehon”, “Bunar Fest 2026”, aktivitetet e “Festës së Qershorit” dhe programet për Ditën e Çlirimit të Prizrenit, të cilat kanë përfshirë mijëra qytetarë dhe vizitorë.

Në sektorin e sportit, vëmendje e veçantë i është kushtuar vitit të Prizrenit si Qytet Evropian i Sportit. Është organizuar ceremonia zyrtare e hapjes, janë zhvilluar aktivitete sportive dhe rekreative në bashkëpunim me klubet dhe federatat sportive, si dhe janë realizuar vizita në terren për identifikimin e nevojave infrastrukturore. Drejtoria ka mbështetur dhe promovuar sukseset e klubeve sportive të qytetit, përfshirë titujt kampionë të KB Bashkimit në Ligën Unike dhe KBF Bashkimit në Superligën e Kosovës.

Në fushën e rinisë është intensifikuar bashkëpunimi me organizatat rinore dhe institucionet arsimore, duke mbështetur iniciativa kreative, edukative dhe artistike për të rinjtë. Janë zhvilluar aktivitete me shkolla, programe për fëmijë dhe projekte që promovojnë përfshirjen aktive të rinisë në jetën kulturore dhe shoqërore të qytetit.

Një ndër prioritetet e drejtorisë ka qenë edhe mbështetja financiare e shoqatave, artistëve dhe sportistëve. Për këtë qëllim është shpallur thirrja publike për subvencione, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në komunë.

Përmes këtyre aktiviteteve është arritur rritja e pjesëmarrjes qytetare në jetën kulturore dhe sportive, promovimi i talenteve lokale, forcimi i bashkëpunimit me organizatat dhe komunitetet si dhe avancimi i imazhit të Prizrenit si qendër e kulturës, rinisë dhe sportit në Kosovë dhe më gjerë.

13. Drejtoria e Pronës dhe Çështjeve Ligjore

Në periudhën **Janar-Qershor 2026** pranë Sektorit për Çështje Pronësoro-Juridike janë pranuar gjithsej **290** lëndë, prej të cilave në afatin e paraparë ligjor janë shqyrtuar dhe aprovuar **255** lëndë, janë refuzuar **26** lëndë, ndërsa **9** lëndë janë në procedurë e sipër.

Më poshtë japim shënime rreth lëndëve të pranura dhe të kryera sipas detyrave të punës dhe procedurat që kryhen pranë Sektorit për Çështje Pronësoro-Juridike, sipas natyrës dhe sistematizimit të punëve:

Procedura e shpronësimit të plotë dhe jo të plotë-servituti dhe procedura lidhur me bartjen administrative (kjo procedurë është zhvilluar në emër të Kryetarit të Komunës, në pajtim me Ligjin Nr.03/L-139.

Lëndë të arritura – 0, të kryera – 0, në procedurë e sipër – 0, të refuzuara - 0.

Procedura lidhur me përpilimin e kontratave mbi qiranë për lokalet pronë e KK Prizrenit dhe kontrolli lidhur me përmbushjen e obligimeve që dalin nga to:

Lëndë të arritura – 262, kontrata të lidhura - 0, vërejtje - 0, vërejtje para padisë - 0, kërkesa 249, njoftime dhe vendime - 0, ekzekutime – 0, konkluzion – 13 dhe konkluzion mbi ekzekutim - 0.

Procedura lidhur me vërtetimin dhe konstatimin e uzurpimit arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore:

Lëndë të arritura dhe të bartura – 5, konkluzione për ndërprerjen e procedurës – 0, njoftime mbi ndërprerjen e procedurës – 1, aktvendime të kryera – 0, lëndët në procedurë e sipër – 4.

Kërkesa të ndryshme - njoftime për Gjykatën Komunale, Asamblenë, palëve dhe për Përfaqësuesin e Komunës, etj:

Gjithsej të arritura – 18 lëndë, të kryera - 13, në procedurë - 5 dhe të refuzuara - 13.

Kërkesa për heqje dorë nga pronësia: kërkesa - 2, në procedurë - 0, të kryera – 2.

Kërkesa për konfirmim të vendimeve pronësore: kërkesa - 3, në procedurë - 0, të kryera – 3.

Verifikimi i pronave komunale përmes gjeoportalit, Gjithsej – 1351 prona komunale.

Puna e Sektorit për Çështje pronësoro-juridike është e lidhur edhe me organet tjera si në kuadër të KK Prizrenit si Avokaturën Publike Komunale, Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorinë e Inspektorateve si dhe me organe jashtë KK Prizrenit – Policinë e Kosovës, etj.

14. Drejtoria e Tatimit në Pronë

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2026, Drejtoria e Tatimit në Pronë ka realizuar këto aktivitete dhe rezultate:

- Janë regjistruar gjithsej 2,485 prona/objekte të reja në sistemin e tatimit në pronë.
- Janë realizuar 9,395 inspektime në terren për verifikimin dhe përditësimin e të dhënave të pronave.
- Janë shpërndarë rreth 5,000 letërkujtesa për tatimpaguesit me obligime të papaguara.
- Janë lidhur mbi 500 marrëveshje për pagesë me këste me tatimpaguesit.
- Të hyrat e realizuara deri më 10.06.2026 janë 1.264.271,06 €.

Këto aktivitete kanë kontribuar në zgjerimin e bazës tatimore, përmirësimin e evidencës së pronave dhe rritjen e nivelit të arkëtimit të tatimit në pronë.

15. Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri

Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri gjatë vitit 2026 ka realizuar këto projekte:

Vazhdimi i projektit dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në qytetin e Prizrenit.

Brigada e Zjarrfikësve gjatë gjashtëmujorit të parë ka pasur 236 intervenime të llojeve të ndryshme.

Pajisje për Brigadën e Zjarrfikësve, Huazim Pompa për fikjen e zjarreve malore nga Parku Nacional Sharri.

Kërkesa të ndryshme për drejtorinë gjithsej: 252.

Intervenime të ndryshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në këtë gjashtëmujor janë: 30.

Intervenimet nga Shërbimi i Zjarrfikësve: Numri i intervenimeve teknike - 43.

Inspektorët e Preventivës:

Pëlqime: 27

Pranime teknike në objekte: 0

Hulumtime në kushte minimale teknike: 8

Hulumtime dhe procesverbale: 30

Raporte zjarri: 7

Hulumtime zjarri: 12

Raport mbi shpenzimet dhe investimet e Kompanisë “KAMILA” Sh.P.K.

Bazuar në faturat dhe fletëpagesat e prezantuara nga Kompania “KAMILA” SH.P.K., komisioni ka konstatuar se kompania në fjalë ka realizuar shpenzime dhe investime në vlerë totale prej 57,603.39€.

Sipas Planit Dinamik të Investimeve për periudhën maj-shtator 2025, kompania ka planifikuar investime në vlerë prej 250,000.00€.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit financiar dhe krahasimit me planin e investimeve, komisioni vlerëson se investimet e realizuara deri më tani arrijnë shumën prej 57,603.39€, që përfaqëson 23.04% të investimit të planifikuar.

Në bazë të të dhënave të prezantuara dhe dokumentacionit mbështetës, komisioni konstaton se investimi është realizuar pjesërisht dhe se niveli i realizimit të investimeve për periudhën e shqyrtuar është 23.04% krahasuar me planin e miratuar të investimeve.

Raport mbi shpenzimet dhe investimet e Kompanisë “FATONI 1” Sh.P.K.

Bazuar në faturat dhe fletëpagesat e prezantuara nga Kompania “FATONI 1” SH.P.K., komisioni ka konstatuar se kompania në fjalë ka realizuar shpenzime dhe investime për ndërtim në vlerë totale prej 322,279.54€.

Sipas Planit Dinamik të Investimeve për periudhën mars – nëntor 2025, kompania ka planifikuar investime në vlerë prej 400,000.00€.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit financiar dhe krahasimit me planin e investimeve, komisioni vlerëson se investimet e realizuara deri më tani arrijnë shumën prej 322,279.54€, që përfaqëson 80.57% të investimit të planifikuar.

Në bazë të të dhënave të prezantuara dhe dokumentacionit mbështetës, komisioni konstaton se investimi është realizuar pjesërisht, në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar.


PËRFUNDIM:

Gjatë periudhës janar–qershor, Komuna ka realizuar një sërë aktiviteteve dhe projektet të rëndësishme në funksion të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe zhvillimit të përgjithshëm të komunës. Puna është karakterizuar nga përkushtimi, transparenca dhe bashkëpunimi me institucionet, komunitetin dhe partnerët. Rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të Kryetarit të Komunës, ekzekutivit komunal dhe të gjithë stafit administrativ për të përmbushur objektivat e përcaktuara në programin qeverisës. Përmes një menaxhimi të përgjegjshëm të resurseve dhe koordinimit të mirë institucional, është mundur realizimi i projekteve dhe ofrimi i shërbimeve cilësore në interes të qytetarëve.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit me qytetarët, duke synuar përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse dhe adresimin e nevojave të komunitetit. Bashkëpunimi me institucionet qendrore, donatorët dhe partnerët zhvillimorë ka qenë një faktor i rëndësishëm në avancimin e projekteve me interes publik.

Edhe në periudhën vijuese do të vazhdohet me angazhim të shtuar për realizimin e prioriteteve të planifikuara, përfundimin e projekteve në zhvillim dhe ndërmarrjen e nismave të reja që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës. Synimi ynë mbetet ndërtimi i një administrate efikase, transparente dhe profesionale, e cila u përgjigjet me përgjegjësi nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, duke krijuar kushte për zhvillim ekonomik, social dhe infrastrukturor të qëndrueshëm.

Shaqir TOTAJ



Kryetar i Komunës së Prizrenit





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi



RAPORTI FINANCIAR

PËR PERIUDHËN JANAR –QERSHOR 2026

Korrik 2026
Prizren

PËRMBAJTJA

I.	TË HYRAT E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT KOMUNAL	3-4
II.	TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE	6-8
	i. Pasqyra e arkëtimit të të hyrave vetanake gjatë periudhes Janar-Qershor 2026	
	ii. Pasqyra e ecurisë së realizimit të të hyrave sipas muajve	
	iii. Pasqyra krahasuese e planifikimit dhe realizimit të të Hyrave Vetanake për periudhën Janar-Qershor 2024,2025 dhe 2026	
	iv. Grafiku I ecurisë së arkëtimit të të hyrave vetanake sipas muajve në vitin 2026	
III.	SHPENZIMET E BUXHETIT KOMUNAL	9-17
	A. Shpenzimet e përgjithshme	
	i. Shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale sipas drejtorive	
	ii. Pasqyra krahasuese e shpenzimeve të Komunës, sipas kategorive, për periudhën Janar-Qershor për vitet 2024, 2025 dhe 2026	
	iii. Grafiku I ecurisë së shpenzimeve sipas muajve në vitin 2026	
	B. Shpenzimet sipas Kategorive dhe Drejtorive:	
	i. Drejtoria e Administratës Komunale	
	ii. Drejtoria Komunale e Shëndetësisë	
	iii. Drejtoria Komunale e Arsimit	
	iv. Drejtoria e Shërbimeve Sociale	
IV.	PASQYRA E TË HYRAVE VETANAKE	18-19
V.	PASQYRAT E SHPENZIMEVE	20-30
Është intensifikuar shërbimi këshillëdhënies për shkollat lidhur me zbatimin e KKK. Përmes drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë shkollat marrin këshilla nga DKA për modalitetet e zbatimit të KKK, për sfidat e zbatimit dhe për zgjidhjet e mundshme të problemeve ad-hoc të zbatimit të KKK. Gjithashtu shkollat vazhdimisht furnizohen me materiale pune, me udhërrëfyes dhe dokumentacion relevant për zbatimin e KKK.

Meqenëse është duke u shtuar përdorimi i mjeteve digjitale në funksion të mësimdhënies dhe nxënies, shkollat janë furnizuar me tabela të mençura si dhe me paisje teknologjike me mbështetje nga partnerët e sektorit të arsimit.

Ka filluar implementimi i digjitalizimit të sistemit arsimor(platformes digjitale).

Për vitin shkollor 2025-2026 drejtoria komunale e arsimit ka hapur thirrjen për 250 bursa për student në vlerë prej 700 euro.

Po ashtu për vitin shkollor 2025/2026 drejtoria komunale e arsimit ndan bursa nga 300 euro për nxënës të shkollave të mesme për fëmijët e invalidëve të luftës dhe nxënës me nevoja të veçanta,

Të dhënat statistikore

Gjatë vitit shkollor 2025/2026 në institucionet publike të menaxhuara nga Komuna e Prizrenit kanë ndjekur mësimin 26983 nxënës, të gjitha shkollat publike me paralelet e ndara, në të tri nivelet e arsimit (0, 1, 2 dhe 3) nga edukimi i herëshëm (fëmijë të moshave 3-4 vjeç) deri në

Numri i nxënësve sipas komuniteteve në Komunën e Prizrenit në vitin shkollor 2025 - 2026															Gjithsej
Etnia	Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët				Niveli i mesëm i lartë			
	Parashkollorë	Parafillore	I	II	III	IV	V	VI	VI I	VI II	IX	X	XI	XI I	
Shqiptarë	792	1507	1716	1751	1791	1734	1756	1802	1762	1839	1707	1799	1737	1608	23301
Boshnjakë	18	76	94	109	120	107	109	131	123	137	150	145	122	132	1573
Turk	31	78	103	91	128	98	110	124	93	113	94	149	147	98	1457
Rom, ashkali, egjiptian	24	49	58	89	64	61	64	65	60	46	52	10	1	2	645
Tjerë...	5	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	7
GJITHS E J	870	1710	1971	2040	2103	2000	2039	2122	2039	2136	2003	2103	2007	1840	26.983

Gjithsej në nivelin e edukimit të hershëm	Shqiptarë	2299	Boshnjakë	94	Turq	109	Rom, ashkali, egjiptian, tjerë	78
Gjithsej në nivelin fillor klasa 1-5	Shqiptarë	8748	Boshnjakë	539	Turq	530	Rom, ashkali, egjiptian, tjerë	336
Gjithsej në nivelin e mesëm të ulët klasa 6-9	Shqiptarë	7110	Boshnjakë	541	Turq	424	Rom, ashkali, egjiptian, tjerë	225
Gjithsej në nivelin e mesëm të lartë klasa 10-12	Shqiptarë	5144	Boshnjakë	399	Turq	394	Rom, ashkali, egjiptian, tjerë	13

shkollat e mesme të larta (klasa e 12), janë si në tabelarin e mëposhtëm.

Struktura e të punësuarëve në arsim në Prizren në vitin shkollor 2024/25

Nr.	KUADRI	SHQIP		BOSHN J		TUR Q		ROM		GJITHSE J		GJITHS EJ
		M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
1	EDUKATOR	1	67	/	9	/	6	/	3	1	85	86
2	MËSUES (I - V)	101	397	52	22	1	32	1	1	155	452	607
3	ARSIMTAR (VI-IX)	361	334	80	30	15	21	/	/	456	385	841
4	MËSIMDHËNËS (X-XII)	162	112	19	13	11	13	/	/	192	138	330
5	DREJTOR	36	18	6	1	/	/	/	/	42	19	61
6	ZV.DREJTOR	3	2	/	/	3	/	/	/	6	2	8
7	SEKRETAR	11	10	/	/	/	/	/	/	11	10	21
8	PSIKOLOG	1	7	/	/	/	/	/	/	1	7	8
9	PEDAGOG	5	2	/	/	/	/	/	/	5	2	7
10	BIBLIOTEKIST	5	6	/	/	/	/	/	/	5	6	11
11	STAF MBËSHTETES	193	21	20	8	11	1	/	7	221	41	262
	TOTALI	879	977	179	86	35	77	14	23	1107	1163	2270

Arsimi i komuniteteve

Në mënyrë periodike takohen drejtorët e shkollave të komuniteteve dhe shkollave në të cilat zhvillohet mësimi edhe në gjuhët e komuniteteve. Një ndër shqetësimet kyçe të këtyre shkollave janë librat mësimorë në gjuhën e komuniteteve, të cilat nuk janë përgatitur me kohë nga MASHTI, gjë që vështirësojnë punën e mësimeve me nxënësit. Deri në pajisjen me materialet mësimore shkollat janë udhëzuar të përdorin burime alternative nga interneti.

Në vijim është paraqitur tabela e numrit të nxënësve sipas përkatësisë etnike:

Numri i nxenesve total sipase etnicitetit ne Komunes e Prizrenit per vitin shkollor: 2025/2026

DREJTORIA KOMUNALE E PRIZRENIT																			
NUMRI I NXENESVE NE FILLIM TE VITIT SHKOLLOR 2025-2026 SIPAS ETNISE																			
Përkatësia etnike	Grupa 1-2	Grupa 2-3	Grupa 3-4	Grupa 4-5	Grupa 5-6	Grupa 5-6	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Gjithsej
Shqiptarë	20	86	333	353	1127	380	1716	1751	1791	1734	1756	1802	1762	1839	1707	1799	1737	1608	23301
Turq	0	2	2	7	78	20	103	91	128	98	110	124	93	113	94	149	147	98	1457
Boshnjakë	0	0	1	3	76	14	94	109	120	107	109	131	123	137	150	145	122	132	1573
Goranë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	2
Ashkalinjë	0	0	0	0	18	0	26	39	19	26	12	25	25	19	12	0	0	1	222
Romë	0	0	6	4	31	14	32	50	45	35	52	39	35	27	40	10	1	1	422
Egjiptianë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Tjetër...	0	0	0	1	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
Gjithsej	20	88	342	368	1334	428	1971	2040	2103	2000	2039	2122	2039	2136	2003	2103	2007	1840	26983

AKTIVITETET:

- Garat Komunale Fizikanit të Ri 2026
- Garat Komunale të Olimpiadës Matematike të Kosovës - OMK 2026
- Olimpiada Informatike e Kosovës 2026
- Gara Komunale - Olimpiada Kombëtare e Kimisë 2026
- Gara Komunale Olimpiada e Gjuhës shqipe
- Testi i Arritshmërisë – Përgatitja e organizimin e Testit të Arritshmërisë për vitin shkollor 2025-2026 i cili mbahet me datën 26 qershor.
- -Testi i Maturës – Përgatitja e organizimit të Testit të Maturës për vitin shkollor 2025/2026, i cili mbahet me datën 20 qershor.
- -Vizita në të gjitha shkollat e mesme të Larta për të kontrolluar dokumentet pedagogjike dhe administrative;

Trajnime, punëtori dhe punë në ekip

- Pjesëmarrje në punëtorinë për të drejtat e fëmijëve;
- Takim i komisionit për komunitetin Romë – Ashkali – Egjiptian, pranë kuvendit komunal;
- Organizimi i procesit mësimor në mësimin jo formal.
- Mbikëqyrja e planeve të punës dhe procesit edukativo - arsimor; kontrollimi i funksionimit të organeve të shkollës etj;
- Bashkëpunimi me prindër, Ekipet e EPRBM të shkollës, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve;
- Monitorimi i shkollave për të kontrolluar plotësimin e standardeve për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të përshtatshëm të mësimdhënies dhe të nxënësve;
- Vlerësimi i brendshëm i shkollës në shkallë kurrikulare – “Monitorimi i nxënësve të shkollave të komunës së Prizrenit;
- Kontrollimi i vlerësimit të brendshëm të shkollave;
- Monitorimi i funksionimit të mjeteve teknologjike i shkollave;

Infrastruktura në shkollat e komunës

Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punët edhe në këto 6 muajt e parë të vitit 2026 me realizimin e projekte dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve të shkollave, si dhe ka monitoruar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore. Janë realizuar aktivitetet e ndryshme si vijon:

- Kompletimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të inventarizimit të shkollave dhe DKA-së tek zyrtarët në Drejtorinë e Financave,
- Vizitat e rregullta nëpër shkolla për verifikimin e pastërtisë dhe higjienës,
- Vizita të rregullta në çerdhen e fëmijëve për të evidentuar kërkesat lidhur me infrastrukturë dhe mallëra.
- Janë mbajtur takimet konsultative me operatorët ekonomikë – punëkryesit lidhur me ndërtimin e objekteve shkollore.
- Janë mbikqyrë punimet e projekteve të cilat vazhdojnë nga vitet e kaluara.

Sa i përket Investimeve Kapitale të planifikuara për vitin 2025, ato janë në fazat si më poshtë:

1. Ndërtimi i çerdhes në Lagjen Tusus Prizren

Deri më tani janë realizuar të gjitha punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) të bodrumit, përdhësës dhe etazhës, të objektit. Poashtu po punohet në installimin e rrjetit elektrik, të ngrohjes qendrore. Janë montuar dritaret në shumicën e hapësirave.

Për momentin, punimet janë duke vazhduar sipas planifikimit të buxhetit. Punimet, për shkak të planifikimit të buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2028.

x



2. Ndërtimi i qerdhes në Fshatin Zhur Prizren


Projekt 3 vjeçar, i planifikuar do të filloj nga viti 2026. Projekti nuk ka filluar së implementuari, për arsye të kontesteve mes komunitetit dhe një pronari të parcelës në kufi të parcelës ku do të ndërtohet qerdhja.

3. Ndërtimi i çerdhes në Lagjen Arbana Prizren

Projekt 3 vjeçar, i planifikuar të filloj nga viti 2025. Projekti për momentin është në pritje të rregullimit të çështjeve pronësore juridike, e më pastaj të vazhdohet me hartimin e projektit zbatues dhe marrjes së lejes ndërtimore.

4. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" Lutogllavë

Deri më tani janë realizuar punimet rreth 85%. Edhe pse nuk kanë përfunduar të gjitha punimet, objekti (me insistimin e Drejtorit të shkollës) është funksionalizuar në tërësi që nga viti 2025. Për momentin punimet janë duke vazhduar kryesisht punimet të jashtme dhe në bodrum.



5. Rregullimi i ambientit të oborreve në shkollat e Prizrenit

Projekti 3 vjeçar, i ka filluar së implementuari. Deri më tani janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat “Vëllezërit Frashëri” në Planejë – Has, “Emin Duraku” në Prizren, “Haziz Tola” Prizren, “Pjetër Budi” Lubizhdë-Has, “Dy Dëshmorët” Serbicë, “Fadil Hisari” Prizren, “Naim Frashëri” Vlashne, është duke u punuar në shkollën “Ekrem Rexha” Lubizhdë. , Kontrata është 3 vjeçare dhe do të realizohet sipas planifikimit të DKA-së, nëpër shkolla.



6. Renovimi i tërësishëm i obj.shk. "Mati Logoreci" Prizren

Projekti 3 vjeçar, i ka filluar gjatë muajit qershor të vitit 2025.

Për shkak të natyrës së punimeve, ky projekt është planifikuar si projekt 3 vjecarë dhe kryesisht do të punohet gjatë mujave qershor, korrik dhe gusht të viteve 2025, 2026 dhe 2027.





7. Digjitalizimi i sistemit te institucioneve arsimore ne shkollat; Emin Duraku, Mati Logoreci, Leke Dukagjini, Abdyl Frasheri, Hysen Rexhepi, Gani Saramati, Ibrahim Fehmiu, Fadil Hisari,

Projekti i planifikuar ka filluar se implementuari nga viti 2025 dhe do të vazhdoj edhe për vitet 2026 dhe 2027.

8. Renovimi i objektit shkollor SHMU "Hysen Rexhepi"

Projekti për shkak të proceduarave të ankesave gjatë prokurimit si dhe për shkak të natyrës së punimeve, është planifikuar që të implemmentohet gjatë muajve korrik dhe gusht të vitit 2026.

9. Renovimi i objektit shkollor ne Fshatin Gjonaj (objekti i vjetër)

Projekt 2 vjeçar, i planifikuar të filloj nga viti 2025. Deri më tani janë realizuar punimet në pastrimin dhe demolimin e materialeve të ndryshme si brenda objektit poashtu edhe jashtë. Pastaj është realizuar ndërrimi i kulmit në tërësi si dhe disa punime tjera të vrazhda. Varësisht nga planifikimi i buxhetit për këtë projekt, punimet parashihen të perfundojnë gjatë vitit 2027.



10. Ndërtimi i Sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Zef Lush Marku" Velezhë

Projekti filluar nga qershori i vitit 2025, dhe sipas planifikimit të buxhetit, i njëjti pritet të përfundojë gjatë fundvitit të 2027 apo në fillim vitit të 2028. Deri më tani kryesisht janë realizuar punimet e vrazhda si, themelet, shtyllat, trajet dhe pllakat për dy nivele.



11. Ndërimi i kalldajave të ngrohjes qendrore, në shkollat; SHFMU "Motrat Qiriazi" lagj. Kurile Prizren, "Luigj Gurakuqi" Nashec dhe "Brigada 125" Medvec

Projekti filluar nga viti 2025, ku është bërë ndërimi i kalldajave në shkollën "Brigada 125" në Medvec dhe "në shkollën "Luigj Gurakuqi" në Nashec. Për momentin punimet janë duke u ekzekutuar në shkollën "Motrat Qiriazi"



12. Ndertimi i Sallës së Edukates Fizike në SHMU Gani Saramati

Projekt 3 vjeçar, filluar nga viti 2025. Deri më tani janë realizuar të gjitha punimet e vrazhda nëpër tri nivelet e objektit. Kanë filluar punimet zejtare, gjegjësisht punimet në instalimin e rrjetit elektrik dhe instalimeve tjera. Po ashtu po suvatosen muret e hapësirave të brendshme. Varësisht nga buxheti projekti pritet të përfundojë gjatë fundvitit të 2027.



13. Ndërtimi i aneksit të shkolles "Fatmir Berisha" Prizren (vlera e kontratës 125,125.00€)

Projekti i filluar nga viti 2025. Deri më tani janë realizuar punimet e vrazhda nëpër nivelet e objektit. Kanë filluar punimet zejtare dhe projekti pritet të përfundojë gjatë vitit 2026.



14. Ndërtimi i deposë për lëndë djegëse për ngrohje në SHFMU "Lekë Dukagjini" Prizren dhe "Mushnikova" Mushnikovë

Projekti i planifikuar të fillojë nga viti 2025, por për shkak të ankesave të shumta gjatë procedurës së prokurimit, do të fillojë së realizuari nga muaji Qershor 2026. Varësisht nga buxheti projekti pritet të përfundojë gjatë fundvitit të 2026.

15. Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Dëshmorët e Zhurit" Zhur

Projekt 3 vjeçar, i cili për shkak të natyrës së punimeve si dhe nënshkrimit të vonshëm të kontratës është planifikuar të punohet gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht të viteve 2026, 2027 dhe 2028.

16. Renovimi i objektit shkollor "Mustafa Bakia" Prizren

Projekti për shkak të natyrës së punimeve si dhe nënshkrimit të vonshëm të kontratës është planifikuar të punohet gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht të vitit 2026, por edhe

nëse do të ketë mjete financiare pasi që ky projekt nuk ka arritur që të paraqitet në buxhetin e vitit 2026 si projekt i rregullt.

Duhet potencuar se 7 projekte nga planifikimi ende nuk janë proceduar për prokurim publik, kjo për arsye se nuk janë aprovuar nga Kryetari i Komunës, e që i njëjti nuk i ka proceduar për arsyet buxhetore Komunale, të cilat janë tani më të njohura.

Pra gjatë vitit 2026, investime kapitale, janë të planifikuara gjithsej 24 projekte, disa prej të cilave 2 kanë përfunduar gjatë vitit fundvitit 2025.

Vlera totale e planifikuar e investimeve kapital për vitin 2026 është 2,240,000.00€

Sipas rrjedhes së punimeve, gjegjësisht realizimit të tyre, deri me datë 31.05.2025, janë realizuar rreth 58,06%, apo e shprehur në pagesa në euro 1,300,603.00€

Gjatë vitit 2026 janë në vazhdim nga viti i kaluar edhe këto kontrata/projekte, nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime si më poshtë:

Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore. E planifikuar për tri vite, në vlerë prej 889,750.00€. Kemi vështërsi edhe në ekzekutimin e punimeve sipas kontratës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Menaxhimi i financave

Drejtoria e Arsimit ka filluar vitin fiskal 2026 me përgatitjet e nevojshme për planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit, në bashkëpunim me institucionet arsimore të komunës. Megjithatë, për shkak të mosmiratimit me kohë të buxhetit komunal, gjatë dy muajve të parë financimi është realizuar sipas sistemit të financimit të përkohshëm, me alokim prej 1/12 të buxhetit të vitit paraprak për secilin muaj, gjë që ka kufizuar realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Pas miratimit të buxhetit, Drejtoria e Arsimit ka hartuar planin e shpenzimeve, ka bërë nënallokimin e mjeteve për shkollat sipas nevojave të tyre dhe ka filluar procesin e zotimit dhe realizimit të shpenzimeve. Megjithatë, gjatë muajit maj 2026, nga buxheti i arsimit fillor janë ekzekutuar mjete nga kategoria e mallra dhe shërbimeve në vlerë prej 392,082.45 euro si dhe nga investimet kapitale të arsimit parafillor me vlerë 250,000 € në bazë të një vendimi përmbarimor, duke ndikuar ndjeshëm në kapacitetin financiar dhe në realizimin e planit të shpenzimeve.

Njëkohësisht, Drejtoria e Arsimit ka trashëguar obligime të papaguara nga viti paraprak në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 673,708.00 euro, të krijuara kryesisht si pasojë e ekzekutimit të vendimeve përmbarimore në vitet e kaluara. Për këtë arsye, gjatë periudhës raportuese prioritet ka qenë shlyerja e këtyre obligimeve, duke racionalizuar shpenzimet dhe orientuar mjetet e disponueshme drejt pagesave të detyrimeve të mbetura. Si


rezultat, janë shlyer obligime në vlerë prej 539,522.00 euro, ndërsa në fund të periudhës raportuese kanë mbetur ende obligime të papaguara në vlerë prej 134,186.00 euro. Kjo gjendje ka kufizuar mundësitë për financimin e nevojave të reja të institucioneve arsimore dhe mbetet sfidë për menaxhimin e buxhetit gjatë pjesës së mbetur të vitit fiskal ku parashihet se do të vazhdojnë ekzekutimet buxhetore.

Në pasqyrën e poshtëshënuar keni përqindjen e shpenzimeve për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe investimeve kapitale duke kalkuluar edhe përqindjen e ekzekutimeve përmbartimore .

Raporti i shpenzimeve aktuale per mallra e shërbime dhe investime kapitale

Përshkrimi	Buxheti Aktual	SHpenzim et	Zotimet/obligi met e papaguara	Mjete te lira	% e shpenzime ve
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	248,955.00	215,859.04	22,527.89	10,568.07	95.8
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET-PRIZREN	405,500.00	285,394.55	66,843.94	53,261.51	86.9
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	2,944,411.78	2,224,610.69	410,918.16	308,882.93	89.5
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZEREN	394,174.00	230,026.03	67,249.75	96,898.22	75.4
21 TË HYRAT VETANAKE	156,093.00	128,868.38	10,000.00	17,224.62	89.0

Përqindja e shpenzimeve nga kategoria e mallra shërbimeve dhe investimeve kapitale





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit (KPZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keqklasifikime në kategori të ndryshme ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,148,191€, pagesa të cilat janë realizuar përmes ekzekutimit të vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.
- B2 Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në raportin vjetor financiar ishin nënvlerësuar për 355,098€.
- B3 Mos raportimi i pasurive jo financiare në PFV si dhe mos mbyllja e investimeve në vijim.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Prizrenit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në dy (2) raste janë identifikuar mospërputhje të sasive të shpenzuara bazuar në peshën e dhënë në dosje të tenderit.
- A2 Mos respektimi i kushteve të pagesës sipas kësteve për leje ndërtimit.
- A3 Mospërdorimi i procedurës së duhur të prokurimit.
- A4 Mungesë e dokumentacionit financiar për urdhrat përmbartimor të ekzekutuar në vlerë 3,884,852€.
- B4 Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare.
- B5 Në 19 raste, faturat në total prej 1,294,286€, kishte vonesa në pagesë prej një (1) deri 516 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar kishin të bënin me prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve, nënvlerësimi i regjistrit tek fusha e pasurive, dhe nënvlerësim i regjistrit të llogarive të arkëtueshme. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte dobësi në iniciimin e projekteve pa mbulesë të fondeve, mos përputhje e sasive të realizuara me ato të peshuara si dhe vonesa në pagesën e faturave.

Po ashtu janë identifikuar dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe mospërdorim të modulit për menaxhim të kontratave në e-prokurim. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Bazuar në të dhënat e Thesarit, shuma totale e pagesave të realizuara në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore për vitin 2025 është 12,695,071€. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, gjashtë (6) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat, në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet ti marrin brenda kufijve të ndarë buxhetor për komunat, duke përjashtuar kategorinë paga dhe shtesa.

Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,148,191€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas urdhrave përmbarimor të gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 1,419,064€, dhe nga investime

kapitale 729,127€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të merr parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Rregullorja Nr. 01/2017 për raportimin vjetor financiar, neni 16 “Raport për të arkëtueshmet” parasheh: organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave, po ashtu neni 6 përcakton se organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në nenin 16 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) në vlerë 29,277,478€, ishin të nënvlerësuar për 355,098€, pasi që drejtorja e urbanizimit nuk i kishte raportuar saktë llogarit e arkëtueshme nga lejet e ndërtimit.

Deri te mos prezantimi i saktë i shumës totale të llogarive të arkëtueshmeve ka ndodhur si rezultat i neglizhencës nga zyrtarët përgjegjës të drejtorisë së urbanizimit.

Ndikimi Prezantimi i llogarive të arkëtueshmeve në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e RVF-së të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën llogarive të arkëtueshmeve.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mos raportimi i pasurive jo financiare në PFV si dhe mos mbyllja e investimeve në vijim.**Gjetja**

Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, paragrafi 3 përcakton që; “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.” Më tutje neni 11 specifikon se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.

Në auditimin e pasurive jo financiare kemi identifikuar se, shtatë (7) pagesa në vlerë 839,226€ që ishin në fazën e investimeve në vijim dhe ende nuk ishin përfunduar, nuk ishin prezantuar, raportuar tek Raporti Vjetor Financiar (RFV), duke rezultuar në nënvlerësimin të pasurive. Këto pasuri ishin për investime kapitale në infrastrukturën publike.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se akoma ka të regjistruara pasuri në kategorinë investime në vijim për vitet 2013 deri në vitin 2023 në vlerë totale 47,270,834€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistra si pasuri në vijim.

Kjo kishte ndodhur si rezultat mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme, ku zyrtarët përgjegjës kishin regjistruar pasuritë e blera por nuk ishin përfshirë në regjistrin kontabël, ku kjo pastaj ka ndikuar në raportim jo të saktë të vlerës së pasurive në PFV.

Ndikimi

Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale ndikon në nënvlerësim të pasurive dhe rezulton në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare vjetore. Po ashtu regjistrimi jo i duhur në procesin e përmbylljes së investimit kapital ka ndikim në vlerën e shpalosjes financiare të pasurive kapitale si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pasurive, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos përputhjes të sasive të realizuara sipas çmimit për njësi të peshuar dhe sasisë së realizuar

Gjetja

Rregullorja Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik paragrafi 54.15 përcakton se: Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët, dhe në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Po ashtu, sipas interpretimit të KRPP-së së datës 09.06.2023, gjatë realizimit të Kontratës Publike Kornizë - Shërbime, Ofruesi i Shërbimeve, faturimin e bënë duke u bazuar në shërbimet e kryera dhe çmimet për njësi të shërbimeve të kontratës (jo çmimeve të peshuara), por nuk lejohet të kaloj vlerën sipas kategorive dhe vlerën totale të parashikuar të kontratës.

Tek kontrata publike kornizë me çmim njësi “Mirëmbajtja dhe mbjellja e druve dekorative në komunën e Prizrenit” me vlerë të parashikuar 210,000€, kemi vërejtur se ka mos përputhje sipas pozicioneve të dhëna në bazë të peshimit dhe realizimit të punimeve. Te kategoria e I që përfshin “Tre pozicione, 1. Prerja e asfaltit, 2. Prerja e drunjëve ekzistues dhe 3 Furnizimi dhe montimi i anësorëve” ishte peshuar 20% apo 42,000€ e vlerës së parashikuar, ndërsa ishte realizuar vetëm 7,681€, kategoria e II që përfshin 36 pozicione “Furnizimin dhe mbjellja e llojeve të ndryshme të drunjëve dhe tjera” ishte peshuar me 50% apo 105,000€ derisa ishte shpenzuar 196,980€ apo 96% e vlerës së parashikuar, dhe Kategoria e III që përfshin “Tre pozicione për rregullimin e konstruksionit nga metali tri modele” ishte peshuar me 30% apo 63,000€ ndërsa ishte vetëm 649€. Kjo kontratë ishte realizuar në shumë prej 205,311€, ndonëse kontrata në total nuk është tejkaluar por kjo ka ndikuar në mos arritjen e qëllimit të planifikimit dhe kontraktimit gjatë realizimit për këto punë; dhe

Në kontratën publike kornizë me çmim njësi “Hartimi i projektit për kolektorët kryesor të qytetit të Prizrenit” me vlerë të parashikuar 100,000€, pozicioni i pestë (V) që përfshin “Studimi i fizibilitetit dhe detalimi i projektit për kanalizimet e reja të cilat nuk kanë qënë të përfshira në studimet paraprake”. ishte peshuar me 5% të vlerës së kontratës që i lejohet të shpenzohet në vlerë 5,000€, ndërsa ishte tejkaluar duke u realizuar 85,094€ apo 85% e vlerës së kontratës gjatë realizimit.

Këto tejkalime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave, përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit dhe mungesës së kontrollit nga menaxherët e kontratave gjatë zbatimit të kontratës.

Ndikimi

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo po

ashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore dhe mosrealizimin e kategorive tjera të peshuara sipas kontratës.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshat e specifikuar në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin sipas peshave të miratuara, për të garantuar përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe objektivat buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos respektimi i kushteve të pagesës sipas kësteve për leje ndërtimit

Gjetja

Bazuar në vendimin Nr. 660689 e datës 08.01.2020 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, mënyra e taksës administrative të pagesës për leje ndërtimit, leje rrënimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në komunën Prizrenit, janë parapare kushtet e pagesës këste ku neni 5 ka paraparë që taksa administrative e cila tejkalon shumën 100,000€, të paguhet në katër këste dhe afati i përmbushjes së obligimeve sipas nenit 6 është parapare në afat prej 18 muajsh.

Kemi identifikuar në katër raste (4) ¹ të lëshimit të lejeve ndërtimore komuna ju kishte mundësuar aplikuesve që pagesën ta kryejnë me këste, mirëpo kjo nuk është respektuar nga ana e tyre dhe nuk ju kanë përmbajtur kushteve të marrëveshjes. Më tutje nuk ishin marrë veprimet nga ana e zyrtarëve përgjegjës që obligimet të kryhen.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve jo adekuate nga zyrtarët përgjegjës të komunës, pasi komuna nuk ka paraparë ndonjë ndëshkim në rast të vonesës së pagesës nga investitori.

Ndikimi

Mos pagesa sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara sipas vendimit të lartcekur, rrit rrezikun e mos përmbushjes së objektivave financiare dhe realizimin e projekteve të planifikuara.

Rekomandimi A2

Kryetari i komunës duhet të sigurojë se do të ndërmerr veprimet ligjore dhe administrative për të gjithë ata atë cilët nuk kanë përmbushur obligimet e tyre me kohë dhe të veproje, duke ndërmarrë hapa/mekanizma ligjor për arkëtimin e të arketueshmeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mospërdorimi i procedurës së duhur të prokurimit**Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 54 pika 54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve/artikujve” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime. Kërkesat nga ky paragraf duhet të vendosen në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Te kontrata “Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura, kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit” me çmim për njësi 5,978.10€, dhe me vlerë të parashikuar 3,000,000€, gabimisht kishte përdorur llojin e kontratës publike kornizë çmim për njësi për punë. Kontrata publike kornizë me çmime për njësi mund të udhëhiqen vetëm për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime, por jo edhe për punë, që me rastin e projektimit për punë të planifikohen sasi të paramasës dhe parallogarisë në bazë të vendndodhjeve të sakta të realizimit të projektit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme prej inicimit të kërkesës nga njësia kërkuuese dhe zyra e prokurimit, për ti respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike për punë.

Ndikimi

Përdorimi I gabuar I llojit të kontratës publike kornizë me çmim për njësi për punë, në raport me projekte me paramasë të sasive të planifikuara - kontraktuara, mund të ndikon që realizimi i projektit të jetë joekonomik dhe jo transparent në raport me konkurruesit apo palët e interesit.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të siguroj që me rastin e kontraktimeve të projekteve kapitale për punë të përdor procedurën e duhur të prokurimit, të kontraktohen më paramasë dhe parallogari të sasive të planifikuara në mbështetje të projektit kryesor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Mungesë e dokumentacionit financiar për urdhrat përmbarimor të ekzekutuar****Gjetja**

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - shpenzimi i parave publike, neni 26 paragrafi 1 përcakton, se asnjë që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e LMFP. Tutje paragrafi 2 përcakton dokumentet që kërkohen për procedimin e pagesave.

Në auditimin e lëndëve të shpenzimeve gjyqësore në kategoritë ekonomike të ekzekutuara në bazë të listës së urdhrave përmbarimor nga thesari për personat juridik dhe fizik, në 30 mostra të urdhrave përmbarimor të ekzekutuar në vlerë totale 3,884,852€, nuk na është ofruar dokumentacioni

financiar mbështetës (Propozimet urdhërat përmbarimor, faturat, raportet e pranimit - situacioneve të punëve, shërbimeve të kryera dhe kontratat).

Kjo ka ndodhur si shkak i mosfunksionimit të duhur të kontrollit të brendshëm të komunës, dhe moskordinimit në mes të drejtorive që janë përgjegjëse për ti ofruara dokumentacionin apo dëshmitë burimore.

Ndikimi Mungesa e dokumentacionit mbështetës për ekzekutimin e urdhrave përmbarimor të ekzekutuar, rrit rrezikun që të ekzekutohen pagesa pa u kryer punët apo shërbimet.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që më rastin e propozim përmbarimit nga përmbaruesi, që lenda është e mbuluar me dokumentacionin e plotë mbështetës financiar dhe gjatë procesit të auditimit të ju ofrohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar auditorëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare

Gjetja Ligji i prokurimit publik Nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 përcakton se, "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla". Po ashtu Ligji i Buxhetit nr. 08/L-332 për vitin 2025, neni 12 paragrafi 7 përcakton se; "Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim".

Kontraktimet e projekteve në vitin 2025 në mungesë të buxhetit janë identifikuar në këto raste si në vijim:

- Kontrata "Renovimi i bibliotekës ndërkomunale në Prizren" në vlerë të kontraktuar 1,488,938€ është kontratë pune investim kapital e cila nuk është e paraparë në buxhetin e kategorisë së investimeve kapitale; dhe
- Kontrata "Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura , kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit" në vlerë të kontraktuar 3,000,000€ me çmim për njësi 3,412.33€ ndërsa në PIP ka pasur mjete në vlerë 2,450,631€ nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 549,369€.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale,

nënshkrimi i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare, rrit nevojën për ridestinime buxhetore për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve si dhe rrezikun e kostove shtesë.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumatat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39.1 i LMFPP përcakton se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në 19 raste, faturat në total prej 1,294,286€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave ishin nga një (1) deri 516 ditë kalendarike.

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur fonde buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna të mos i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte në vlerë 29,870,058€ deri sa realizimi ishte 29,811,601€.

Çështja A5 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik

